

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7450 E shtunë 24 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Mesazhi Ditës

Vizita e nesërme e Presidentit Juncker në Shqipëri, vetëm dy javë pas shpalljes së Strategjisë së Komisionit për Ballkanin Perëndimor, është ...
Vijon në faqen 11

Nga ROMANA VLAHUTIN

Detyra e brezit tonë



Opinion Ditës

P prej ditësh opinionimi publik është sy e veshë nga media dhe politika duke ndjekur me kërshtëri dhe interes të madh çështjet delikate të negociatave tona ...
Vijon në faqen 12

Nga HABJON HASANI

Pse Greqia hapi "shampanjën" e festës?



Biletat e tragetit të Elena Avdillarit
Përplasja e makinave në Maminas, reagon policia e Durrësit: Ishte aksident i pastër

23-vjeçarja bëri 'check-in', u kthye në port nga kufitarët. "Shoferi i 'Benz'-it s'ka lidhje"

Nga KLODIANA HAXHIAJ
Pasagjerja 23-vjeçare Elena Avdillari dhe shoferi i taksisë Bujar Agalliu humbën jetën aksidentalisht, pas goditjes nga automjeti tip "Benz" në afërsi të Maminasit". Ky është përfundimi, në të cilin ka arritur policia ...
Në faqen 7

LISTA E PLOTE E 1026 PERSONAVE QE U NJIHET E DREJTA PER KOMPENSIM E VLERESIM PER TRI VITE

ISH-PRONARET, MBYLLEN DOSJET PER VITET '93-'96

Përditësohen të dhënat, subjektet që konsiderohen të kompensuar. Nga 1300 aplikime, rreth 400 persona janë trajtuar deri më tani për këtë periudhë



(Në foto) Toka

QEVERIA NE BERAT

Ndihma sociale, Edi Rama: Kishte skandale. Basha: Është mashtrim

Në faqen 3

AKTIVITETI ME BE

Zguri: Partitë politike, mision të fshehin të ardhurat e shpenzimet

Në faqen 2

DOSJA "HABILAJ"

Prokuroria, letër-porosi në Itali për dëshmitë e Moisiut dhe Seitit

Në faqen 6

KRITERET

Pensionet e të emigruarve në Itali, dokumentet për të përfituar lehtësisht

Në faqen 9

ISH-BANORJA E "BB 9": RAPORTI IM ME BERNARDIN



Xheni Mhillaj: Momenti kur do të më shihni nuse, projektet e reja

Aksidentet e fundit? Kreu i policisë rrugore: Në 2017-ën ka ulje në raport me 2016-ën

Tola: Do kërkojmë trefishim të gjobave për celularët

"Drejtuessit e mjeteve nuk respektojnë kufijtë e shpejtësisë, koha për ndryshime në Kod"

Kreu i Policisë Rrugore, K Mitat Tola deklaroi dje se është gati propozimi ligjor për të trefishuar gjobat për përdorimin e celularit nga shoferët gjatë drejtimit të automjetit. I ftuar në "Ekopolitikë" nga Aurora Sulçe në "Ora News", Tola tha se do të ashpërsohen



masat për përdorimin e celularit nga drejtuesit e automjeteve. "Ta sqaroj edhe problemin e celularit. Ka një diskutim të madh që donim ta kalonim në 2014-ën. Kaluam vetëm rripin e sigurimit dhe sot nga 20% ka kaluar mbi ...
Në faqen 5

ZGJEDHJET FINANCAT

Kreu i KQZ-së, në prani të BE e KiE: Duhet mekanizma monitorimi

Darina Tanushi

Zguri: Partitë politike, mision të fshehin të ardhurat e shpenzimet

"Korrupsioni në financim është shitblerje e votës"

Kryetari i KQZ-së, Klement Zguri akuzoi dhe partitë politike se "kanë mision fshehjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve të realizuara gjatë vitit kalendarik, por edhe në vitet zgjedhore". Në fjalën e mbajtur në trajnimin për "Auditimin e raporteve të financimit të partive politike dhe të fushatës zgjedhore", organizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, Zguri u shpreh se për këtë duhen kombinuar kuadri ligjor me domosdoshmërinë e ngritjes së strukturave të mbikëqyrjes, monitorimit dhe kontrollit profesional e rezultativ të financave. Në prani edhe të përfaqësuesve të BE-së dhe KiE-së, Zguri tha: "E kam thënë edhe më parë dhe do të vazhdoj ta theksoj që korrupsioni në financim është rruga pa shpëtim, është shitblerje e votës, është abuzim me resurset shtetërore, është rrënim i paritetit në garë, është dhunim i vullnetit të lirë të zgjedhësve, është kapje e pushtetit politik nga krimi dhe antishteti. Korrupsioni në financim nuk është delikt kavalierësh, por është armiku më i egër i zgjedhjeve". Ndaj të gjithë në duhet të japim kontributin tonë për të rritur transparencën e financimit të partive politike, si antidotin e korrupsionit zgjedhor. Neni 9 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që partitë politike duhet të organizohen në përputhje me parimet demokratike dhe që burimet financiare e shpenzimet e tyre të bëhen kurdoherë publike. Ndërkohë që me ligjin mbi të drejtën e informimit, transparencë publike është bërë kriter vlerësimi dhe standard baze për çdo institucion publik, ku bëjnë pjesë edhe partitë politike, si organizata që kryejnë aktivitet kushtetues dhe kanë të përfshirë funksionare publikë. Është shumë e vështirë të fshehësh korrupsionin dhe praktikën e gabuar në rast se publiku ka dijeni", u shpreh kreu i KQZ-së. "Megjithatë - shtoi ai - partitë politike në Shqipëri nuk i publikojnë vetë deklarimet financiare për publikun e gjërë, si dhe për anëtarët e tyre. I vetmi informacion është ai që mundëson Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ. Pra, partitë politike vijojnë të jenë të mbyllura për publikun dhe hermetike për transparencën dhe llogaridhënien publike. Në vendin tonë par-



Kryetari i KQZ-së, Klement Zguri

titë politike e kanë mision fshehjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve të realizuara prej tyre gjatë vitit kalendarik dhe gjatë vitit zgjedhor, por misioni i KQZ-së dhe i juaji si audit kontabël është bërja transparente financave të tyre", theksoi Zguri.

Sipas kreut të KQZ-së, "legjislacioni mbi partitë specifikon parime e standarde që lidhen me rregullat demokratike të funksionimit, por nuk ka krijuar mekanizma institucionalë të monitorimit të zbatimit të ligjit, përveç Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve, i cili kontrollon vetëdeklarimet e partive politike nëpërmjet audituesve të licencuar". Ndryshimet e fundit ligjore kanë sjellë përmirësim të transparencës së financave të partive politike, por jo transparencë të plotë.

"Qeveria shqiptare duhet ta dijë sa seriozisht e shohim korrupsionin"

DASH: Tillerson s'ka keqinformim për Lllallën, do ketë ndëshkime të tjera

Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit, i pyetur nga "Politiko.al" nëse DASH ishte "keqinformuar" nga Ambasada amerikane në Tiranë mbi rastin "Llalla", siç pretendoi ky i fundit në një deklaratë për WSJ, tha se sekretari Tillerson ka pasur "informacione të besueshme mbi përfshirjen e Adriatik Lllallës në korrupsionin sinjifikativ gjatë mandatit të tij si kryeprokuror". Zëdhënësi ka pranuar gjithashtu se, në Departament po shqyrtohen raste të tjera të korrupsionit të zyrtarëve dhe se "piketimi" i Lllallës është i rëndësishëm për faktin se "qeveria shqiptare dhe populli shqiptar duhet ta dijë se sa seriozisht e shohim ne korrupsionin".



Zëdhënësi i DASH sqaroi këtë vendim të pazakontë të SHBA-ve për një zyrtar shqiptar, pra shpalljen "non grata" të ish-kryeprokurorit. "Klauzola 7031(c), jo vetëm që e skualifikon një zyrtar të një qeverie të huaj nga mundësia për vizë amerikane, në rastin kur ai është përfshirë në korrupsionin sinjifikativ, por gjith-

ashtu kërkon që edhe anëtarët e familjes së afërt të atij zyrtar të skualifikohen nga kjo mundësi". Sipas këtij zëdhënësi të DASH, sekretari i shtetit Rex Tillerson "ka informacione të besueshme që z.Llalla ka qenë i përfshirë në korrupsionin sinjifikativ gjatë mandatit të tij si Prokuror i Përgjithshëm". "Kur sekretari merr informacion të besueshëm se një zyrtar është përfshirë në korrupsionin sinjifikativ dhe/apo dhunim të drejtave të njeriut, ai është i kushtëzuar që ta 'piketojë' atë zyrtar dhe anëtarët e familjes së tij, duke përdorur klauzolën 7031(c). Në jemi, në mënyrë aktive, duke shqyrtuar raste dhe do ta përdorim këtë autoritet në mënyrë globale.

VIZITA


Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, do të vijë në Shqipëri më 25-26 shkurt 2018, si pjesë e një vizite në Ballkanin Perëndimor. Në Tiranë, presidenti Juncker së bashku me komisionerin Johannes Hahn do të zhvillojnë takime me kryeministrin Edi Rama dhe presidentin Ilir Meta.



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

**"Pakti detar"
Kotzias, opozitës greke: Tregoni përgjegjshmëri**

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, i ka rekomanduar partisë më të madhe opozitare, Demokracia e Re, të tregojë përgjegjshmëri në çështjet e politikës së jashtme. Ndërhyrja e shefit të diplomacisë greke është bërë në parlament, në përgjigje të kërkesës për interpelancë, që kishte bërë shefi i departamentit të mbrojtjes të partisë opozitare, deputeti Vasilis Kikilias. Tema e interpelancës ka qenë përsëri i lidhur me negociatat që Greqia po zhvillon me Shqipërinë për rishikimin e Paktit Detar. Deputeti konservator kërkon të dijë nëse "në përlogaritjen e re të ujërave territoriale do të garantohet influenca e ishujve Diapontianë" - (kompleksi i ishujve të vegjël në veri perëndim të Korfuzit), si dhe nëse "shelli kontinental me Shqipërinë do të ketë të njëjtin vlefshmëri që ka dhe me Italinë, i delimituar që nga viti 1977", njofton korrespondenti i "Ora News". Kotzias i ka rekomanduar deputetit të opozitës që "ta riformulojë pyetjen". "Politika e jashtme do të duhet të ushtrohet me kthjelltësi, përgjegjshmëri, seriozitet dhe efikasitet, dhe jo për hatër të marketingut të brendshëm politik", tha Kotzias.



Ish-kryeministri suedez, mesazh në shqip: Meritoni negociatat

Shqipëria duket të jetë shumë pranë se kurrë hapjes së negociatave me Bashkimin Evropian. Këtë e pranojnë edhe zyrtarë të lartë të BE, të cilët shprehen se Shqipëria e meriton këtë hap të rëndësishëm. Ambasadori austriak në Shqipëri, Johann Sattler, shkruan në "Twitter" se Shqipëria e meriton dhe se ka ardhur koha për hapin e radhës. "Po, Shqipëria e meriton. Koha për hapin e radhës. Negociatat janë fillimi, jo mbarimi i procesit të thellë të modernizimit/reformimit", shkroi kryediplomati austriak. Ajo që tërheq jo pak vëmendje në postimin e tij është një koment i ish-kryeministrit dhe ish-ministrit të Jashtëm suedez, Carl Bildt, i cili pohon të njëjtin gjë. Bildt shkruan në komentin e tij se Shqipëria meriton negociatat. "Shqipëria meriton negociatat."



Qeveria në Berat, kryeministri: Asnjë veper industriale, ku cenohet turizmi

Ndihma sociale, Rama sqaron skemën e re: U hoqën personat e aftë për punë

"Kishte skandale, Këshilli Bashkiak i Kukësit merrte për vete"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama premtoi dje nga Beratit se qeveria e tij nuk do të lejojë asnjë lloj veprë industriale, aty ku cenohet turizmi. Pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri u shpreh: "Patjetër që kjo nuk do të thotë që nuk do ndërtohen më HEC-e në Shqipëri, por do të jemi shumë të vëmendshëm dhe do të veprojme me vetëdije të plotë kombëtare. Ndërkohë, ministri i Turizmit dhe Mjedisit po udhëheq edhe një tjetër proces, krijimin e hartës së Parkut Kombëtar të Vjosës për të ndarë përfundimisht pjesën ku nuk do të ketë asnjë ndërhyrje nga pjesa ku është ndërhyrë apo ku mund të ketë, - nuk e di nëse në të ardhmen do të duhet se nuk është se kemi ndonjë zhvillim të kësaj natyre në horizont, - zhvillime të tjera të natyrës që lidhet me industrinë elektroenergjetike". "Ne jemi absolutisht të vendosur që të përballemi me të gjitha minat që janë vendosur në rrugën tonë në të shkuarën. Ka shumë mina në çdo hap, në çdo sektor. Por, nga ana tjetër, jemi edhe më të vendosur, më të vëmendshëm dhe më të vetëdijshëm që ne nuk do t'i vëmë më asnjë minë Shqipërisë në asnjë sektor, që do të thotë se me HEC-et e trashëguara, pra me të drejtat e trashëguara ka gjithmonë probleme, siç ndodhi me Valbonën, ku ne e minimizuam atë që pritej të ndodhte për shkak të një serie lelesh të dhëna, por nuk arritëm dot ta neutralizojmë plotësisht, sepse përndryshe do të përballëshim pastaj me një histori gjyqesh e arbitrazhesh që mund të na kushtonin shumë herë më rëndë, përveçse edhe rikthimin e së drejtës për të vazhduar këtë histori", sqaroi Rama.

NDIHMJA EKONOMIKE

I pyetur nga gazetarët se çfarë do të bëhet me ato familje që kanë dalë nga ndihma ekonomike, Rama tha se "ka një manipulim të madh politik". "Ndërkohë që skema është e njëjta, skemë e cila u pilotua për 2 vjet në tri qarqe, në Tiranë, Elbasan dhe Durrës, që nxori 19.100 abuzues vetëm në tri qarqe dhe që tani shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Nëse skema pati



Kryeministri Edi Rama

sukses në këto tri qarqe, nuk ka pse të mos ketë sukses në të gjithë Shqipërinë për të ndarë ata që merrnin ndihmë ekonomike dhe janë mijëra e mijëra të tillë, padrejtësisht, me ata që meritonin ndihmë ekonomike", sqaroi ai. "Skema është e

ftohtë. Pra, është kompjuterike. Nuk është skema e dikurshme kur kemi parë gjëra skandaloze, deri në nivelin që këshilli i tërë bashkiak i Kukësit i jepte ndihmë ekonomike vetes së vet, për çdo anëtar. Kjo, për të sjellë një rast ekstrem. Por

GURORËT

Kryeministri paralajmëroi se do të bllokohen të tjera gurorë. "Çdo kompani, çdo sipërmarrje që kërkon të shfrytëzojë malet dhe kodrat për të nxjerrë gurë duhet në të njëjtën kohë të zbatojë rigorozisht të gjitha standardet e kontratave, sepse kontratat janë të qarta dhe standardi është i qartë: Nuk mundet të kafshosh, të gllabërosh dhe të ikësh! Paralelisht duhet të rehabilitosh, të ripërtërisht", theksoi Rama, duke iu referuar gurorëve në malin e Tomorrit.

ka, siç është pranuar dhe është ditur që në fillim, edhe nga vetë ekspertët e Bankës Botërore, se është një projekt i përbashkët me Bankën Botërore, një institucion lider në luftën kundër varfërisë, marzhin e vet të gabimit", sqaroi ai. Pikërisht se skemat kanë marzhin e vet të gabimit, ka një proces rivefikimi dhe rivlerësimi dhe jemi në këtë proces. Pra, patjetër që ka raste që nuk përputhet rezultati që ka dhënë skema me nevojën e një familjeje apo një familje tjetër dhe për këtë familje të gjitha do të gjenden rruga për t'i përfshirë në skemë tha Rama. Ama 70% e atyre që kanë pretenduar të përfshihen e nuk janë përfshirë në skemë, janë persona nga 24 deri në 45 vjeç, plotësisht të aftë për punë, dhe unë nuk mund ta pranoj që investime të kryera, - po marr shembuj në zonën e Delvinës, për fabrika, - të rrezikojnë të falimentojnë për shkak se nuk shkon njeri të punojë. E nga ana tjetër, ata që janë të aftë për punë, të kërkojnë ndihmë ekonomike, ndërkohë që u ofrohet punë", theksoi Rama. "Atëherë, nëse më thua që unë dua të marr 50 mijë lekëshin e mesatares, - se ndihma ekonomike mund të shkojë deri në 110 mijë lekë për familje që plotësojnë kriteret, por po marr mesataren, - e të rri në kafene e të mos shkojë në punë, unë them më vjen shumë keq, por kjo nuk është e mundur sepse ajo mesatare minimale është për familjet që realisht janë në nevojë. Nuk është për ty që je 25 vjeç, që je 30 vjeç, që je 35 vjeç, që je 40 vjeç dhe që nuk do të punosh. Kjo është përgjigja ime", tha Rama.

Raportet me Metën, kryeministri: Mirënjohës, më prezantoi kanionet

Kryeministri Edi Rama refuzoi t'i përgjigjet Presidentit Ilir Meta, i cili ende nuk e ka dhënë autorizimin për Ministrinë e Jashtme, në mënyrë që ajo të vijojë përfundimin e negociatave me palën greke për paktin detar. I pyetur në Berat për këtë çështje, Rama preferoi ta kalojë me batutë. "Unë ndaj me presidentin të gjithë dashurinë për kanionet dhe të gjithë vëmendjen që kanionet të jenë një nga pikat më intensive të zhvillimit të turizmit dhe të ekonomisë së Beratit. Për sa i përket pyetjes suaj, besoj se unë e kam dhënë përgjigjen time dhe nuk i heq asnjë presje. Nëse ju keni ardhur deri këtu, për të nxjerrë një lajm se ka një problem mes meje dhe presidentit, është vendi më i gabuar për ta bërë këtë, sepse jemi jo larg kanioneve e mbi të gjitha unë kam dhe detyrimin e mirënjohjes ndaj presidentit që më ka prezantuar me kanionet dhe falë ftesës së tij, kam bërë dhe rafting për herë të parë", iu përgjigj Rama gazetarëve. "Ju ftoj edhe juve që të vini, sapo të fillojë koha e rafting dhe të bëni edhe ju rafting, siç kam bërë unë. Atëherë do kuptoni se pse përgjigja ime këtu nuk është aspak ironike dhe aspak për t'i ikur pyetjes tuaj, por është e vetmja përgjigje që unë mund të jepja përderisa erdhët deri këtu për presidentin", tha më tej Rama.



LULZIM BASHA

Pas deklaratës së Ramës për ndihmën sociale, kreu i PD-së u shpreh: "A ka njeri që e beson mashtrimin e Ramës nga Beratit se njerëzit preferojnë të marrin 50 mijë lekë ndihmë ekonomike në vend që të punësohen me rroga 400 mijë lekëshë? Realiteti flet vetë me gojën e këtyre banorëve të Beratit, aty ku banda qeveritare po harxhon sot e nesër miliona lekë për ekskursionin e fundjavës, por asnjë kacidhe për njerëzit në nevojë ekstreme".



Bushati: Ballkani Perëndimor po shihet si fushë shahu gjeostrategjike

"Shqipëria dhe fqinjët e saj mund të bashkohen me Bashkimin Europian brenda një dekade", deklaroi ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati në një intervistë për agjencinë prestigjioze të lajmeve, "Reuters", duke dukur mbi procesin e integrim-it në BE të Ballkanit Perëndimor. I pyetur për shkallën e ndikimit të Rusisë, Turqisë apo Kinës në rajon, Bushati thotë: "Ballkani Perëndimor shihet si një fushë shahu gjeostrategjike". "Shqipëria i mirëpret investimet nga vendet e tjera, përfshirë Japoninë", tha ai. "Nuk ka alternativë tjetër veçse ajo e anëtarësimit në BE", theksoi Bushati. Ministri Bushati e ka bërë këtë intervistë gjatë punimeve të konferencës së Sigurisë së Mynihut. Ndërkohë, artikulli i "Reuters" i kushton një vëmendje edhe takimit mes kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev me kancelaren Angela Merkel, ku kjo e fundit premton se do të përpiqet të përshpejtojë procesin, ndonjëherë të ngadalshëm, të zhblokimit të fondeve të BE-së të destinuara për Ballkanin. "Ne evropianët nganjëherë kemi nevojë për shumë kohë. Kjo nuk është domosdoshmërisht një çështje se sa, por sa kohë duhet", tha Merkel, duke vënë në dukje procedurat e gjata të planifikimit të projekteve të tilla si ndërtimi i autostradës, që mund të shqetësojë vendësit.

KODI I SJELLJES DEPUTETET

Kod i ri sjelljes në parlament, si duhet të sillen ligjvënësit?

Deputetet, në sallën e Kuvendit me fëmijët e porsalindur

Penalizimet në rastet e shkeljes së kodit

Valentina Madani

Parlamenti tashmë ka gati amendamentet për "Kodin e Sjelljes së Deputetëve", i cili pritet të miratohet në seancën e ardhshme plenare. Një nga pesë propozimet është se deputetet do të kenë mundësi të marrin në sallë edhe foshnjat e tyre. Kodi i ri i sjelljes së deputetëve synon që t'i japë fund gjuhës së urrejtjes në parlament. Tjetër pikë e rëndësishme është edhe fakti se tashmë deputetet nuk do të përfitojnë nga imuniteti i tyre për t'u shmangur arrestimeve. Konkretisht propozohet: 1. Ndalohet gjuha e urrejtjes në parlament. Fjalët provokuese do të jenë rreptësisht të ndaluara nga deputetet dhe ata që fyejnë e kërcënojnë njëri-tjetrin, duhet të kërkojnë falje. 2. Një deputeti i ndalohet të votojë në emër të dikujt tjetër, në këtë rast votimi do të quhet i pavlefshëm. Do të ekzistojnë rregullat strikte se si votohet. 3. Deputetet që kanë fëmijë të porsalindur mund t'i marrin ato me vete në punimet parlamentare. Partia Socialiste ka propozuar një nen shtesë në Kodin e Etikës së deputetëve që pritet të miratohet të hënën, ku detyrohet Kuvendi që të krijojë kushte të posaçme për foshnjat e tyre, teksa nënat janë duke kryer punime parlamentare. Dokumenti është depozituar të enjten nga Vasilika Hysi. Kjo është hera e parë që një përcaktim i tillë futet në legjislacionin shqiptar. 4. Staf i Kuvendit nuk duhet të përdoret për qëllime partiake jashtë punës parlamentare. 5. Deputeti nuk duhet të përfitojë nga imuniteti i tij për të abuzuar me pushtetin dhe për të shmangur arrestimin për kryerjen e një krimi të rëndë, përfshirë korrupsionin apo shpërdorimin e detyrës. Ky nen vjen pas porosisë së Brukselit në mbledhjen e Komitetit të Stabilizim Asociimit, që zyrtarët të mos përfitojnë nga imuniteti. Kjo pikë mund t'i kujtojë opozitës rastin e "Saimir Tahirit" dhe ta quajmë këtë nen hipokrizi. Por pavarësisht pikës 1, që thotë se deputeti nuk duhet të përfitojë, pika 2 e të njëjtit nen zhvlerëson pikën 1, duke thënë se hejja e imunitetit do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Nëse deputetet nuk u përmbahen këtyre rregul-




HAPJA E DOSJEVE
 Autoriteti për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit informoi dje 250 aplikime nga personeli i Shërbimit Diplomatik, dorëzuar për verifikim figure në AIDSSH për t'u përgjigjur pyetjeve nëse personi ka qenë bashkëpunëtor aktiv apo i favorizuar i Sigurimit, nëse ka qenë i ndjekur për spiunazh të huaj apo për terrorizëm dhe se si figuron në dokumentet e Ish-Sigurimit.

KODI I RI I SJELLJES, PROPOZIMET

1. Ndalohet gjuha e urrejtjes në parlament. Fjalët provokuese do të jenë rreptësisht të ndaluara nga deputetet dhe ata që fyejnë e kërcënojnë njëri-tjetrin, duhet të kërkojnë falje.
2. Ndalohet votimi i deputetëve në emër të njëri-tjetrit. Do të ekzistojnë precedentet që formësojnë rregulla strikte se si votohet.
3. Deputetet mund të vijnë në Kuvend me fëmijë të porsalindur, pasi do të krijohen hapësira të posaçme që të marrin pjesë nënat bashkë me foshnjat.
4. Staf i Kuvendit nuk duhet të përdoret për qëllime partiake, por secili të mbajë përgjegjësi për vendin e tij.
5. Deputeti nuk duhet të përfitojë nga imuniteti i tij parlamentar për të shmangur arrestin, nëse ka një akuzë ndaj tij.

PD, rezolutë kundër kërcënimeve e fyerjeve të gazetarëve nga zyrtarët shtetërorë

PD-ja do iu drejtua Kuvendit me një rezolutë për të dënuar kërcënimet dhe fyerjet e zyrtarëve shtetërorë kundrejt gazetarëve. Deputetja e PD dhe kryetarja e Komisionit të Medias, Albana Vokshi u shpreh se PD do të kërkojë zhvillimin e një debati në Kuvend për sjelljet e papranueshme dhe të paprecedenta ndaj gazetarëve të zyrtarëve të lartë shtetërorë si dhe do të dërgojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend edhe një projekt-rezolutë për dënimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe poshtëruese ndaj gazetarëve. "Shantazhimi dhe intimidimi i kryeredaktorës së 'Monitor', Ornela Liperi dhe kryeredaktorit të 'Panorama', Robert Rakiplari, gjatë një përballje televizive me kryetarin e Bashkisë së Tiranës dëshmon që liria e mediave në Shqipëri është rrezikuar. Përdorimi i gjuhës së dhunshme, shantazheve, përmirimi dhe sulmet politike ndaj gazetarëve inkurajojnë dhunë



Deputetja e PD-së, Albana Vokshi



KËRKESA

Në mbështetje të nenit 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, PD do të kërkojë zhvillimin e një debati në Kuvend për sjelljet e papranueshme dhe të paprecedenta ndaj gazetarëve të zyrtarëve të lartë shtetërorë në Shqipëri.

edhe fizike ndaj tyre dhe akte që ndikojnë në lirinë e shprehjes në Shqipëri. Komiteti i Stabilizim Asociimit në Deklaratën e Përbashkët mes Parlamentit europian dhe atij shqiptar ngriti shqetësimin për ndikimin e madh të interesave ekonomike dhe politike që rrisin autocensurën dhe rrezikojnë lirinë e shprehjes

dhe sigurinë e gazetarëve. Personazhi i 'njëmijë e një historive' korruptive me pasoja kriminale, siç ishte shfrytëzimi për vdekje e grave dhe fëmijëve në landfillin e tij në Sharrë dhe rekordmen i mashtërimeve u vetëdeklarua si 'gjobitës' i korporatave mediatike", u shpreh zj. Vokshi.

lave, do të merren masa. Peshë juridike e Kodit të Etikës është sa një vendim i Kuvendit, më i brishtë se rregullorja, ligjet në fuqi, Kodi i Procedurës Penale,

apo Kushtetuta që rregullon procedurat e arrestimit të një deputeti. Ndryshimet e reja janë formuluar nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste me ndihmën e

OSBE-së. Kjo shihet si një emergjencë pas detyrimit që Brukseli dha për anëtarësimin e vendit në BE dhe si një risi për Kodin aktual Etik të deputetëve.

INSTAT largon nga puna drejtorin e sapoemëruar

PD-ja akuzoi dje kryeministrin Rama se ka kthyer në punë, në një pozicion shumë të rëndësishëm Erjon Manohasën, të cilin Gjykata Administrative e kishte shkarkuar për shpërdorim detyre. Zëdhënësjja e PD-së, Ina Zhupa tha: "Emërimet e dyshimta të Edi Ramës në pika kyçe të administratës janë treguesi më i qartë se zpra fasadës dhe propagandës për 'bashkëqeverisje me njerëzit e zakonshëm' qëndron tepsia e pushtetit të korruptuar. Për këdo që nuk e njeh, Erjon Manohasa ka qenë deri para pak kohësh drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, që menaxhon interesat multimilionere të shëndetësisë. Por drejtori i tepsisë së pushtetit, përfaqësues i PDIU-së, u shkarkua nga detyra me vendim gjykatë për shpërdorim detyre, sepse dyshohej se firmosi një kontratë korruptive për një laborator hemodialize në Durrës, që nuk plotësonte asnjë kusht për këtë shërbim jetësor për të sëmurët. Pas akuzave të PD-së reagoi edhe INSTAT, i cili beri të ditur se i ka kërkuar dorëheqjen Manohasës dhe ai e ka pranuar.

Analiza e humbjes, PD: Zgjedhjet e reja, brenda qershorit

PD ka përmbyllur procesin e analizës. Në seli janë dorëzuar të gjitha raportet dhe rekomandimet e krerëve të degëve, si dhe raportet konfidenciale të të deleguarve të kryetarit në çdo qark. Dy janë faktorët kryesorë që sipas demokratëve sollën humbjen e thellë: blerja e votave dhe problemet e brendshme. Krahas analizës, në PD kanë mbërritur edhe propozimet për ndryshimet statutore. Me përmbylljen e kësaj faze, kryetari demokrat pritet të thërrasë kryesinë e partisë, e cila do të dalë me konkluzionet përkatëse. Me evidentimin e shkaqeve të humbjes, demokratët janë gati për një fazë të re, atë të riorganizimit të partisë. Analiza e zgjedhjeve zgjati përtej afatit dymujor të përcaktuar nga Lulzim Basha, por zgjedhjet brenda partisë pritet të mos marrin aq shumë kohë. Sipas "News 24" zgjedhjet e reja parashikohen të mbyllën brenda qershorit. Në zgjedhje pritet të futen të gjitha strukturat e partisë, degët, departamentet, sekretariatet, kryesia dhe këshilli kombëtar. Brenda dy javëve pritet që kryetari demokrat të lëshojë udhëzimin për procesin, afatet, kriteret e kandidatimit dhe modalitetet.

Kreu i policisë rrugore: Ka ardhur koha të ndryshojmë kodin e rregullave

Mitat Tola: Do kërkojmë trefishim të gjobave për celularët në makinë

Aksidentet e fundit? Në 2017-ën ka ulje të numrit në raport me 2016-ën

Kreu i Policisë Rrugore, Mitat Tola deklaroi dje se është gati propozimi ligjor për të trefishuar gjobat për përdorimin e celularit nga shoferët gjatë drejtimit të automjetit. I ftuar në "Ekopolitike" nga Aurora Sulçe në "Ora News", Tola tha se do të ash-përsohen masat për përdorimin e celularit nga drejtuesit e automjeteve. "Ta sqaroj edhe problemin e celularit. Ka një diskutim të madh që donim ta kalonim në 2014-ën. Kaluam vetëm rripin e sigurimit dhe sot nga 20% ka kaluar mbi 60% që e vendosin. Bëmë kërkesë që të ashpësonim edhe për celularin. U pa si një masë shumë e rëndë. Kërkuam dyfishimin. Ne me celular e humbasim vëmendjen. Për mua duhet të trefishohet. E kemi gati", deklaroi ai. "Ka ardhur koha që Kodi Rrugor të ndryshojë. Transporti është në lëvizje. Në Shqipëri janë mbi 600 mijë automjete", shtoi kreu i Policisë Rrugore. Duke folur për aksidentet tragjike të ditëve të fundit, Tola tha: "Në 2017-ën në raport me 2016-ën ka ulje të numrit të aksidenteve dhe ulje të numrit të viktimave.



Kreu i Policisë Rrugore, Mitat Tola

Pse ndodhin aksidentet? Ne vazhdojmë të jemi akoma një vend ku drejtuesit e mjeteve nuk e përdorin mjeh-tin konform normave të për-

caktuara në legjislacionin rrugor, nuk respektojnë kufijtë e shpejtësisë, mospërdorimin e alkoolit dhe shkelje të tjera që sjellin

tragjedi të tilla. Gjithë muaji shkurt numëronte gjithsej 6 të vdekur, ndërsa vetëm në dy aksidente kemi 6 të vdekur", tha Tola.

Faturat e energjisë, mbi 65 për qind e familjeve kanë vështirësi me pagesat

Mbi 65% e familjeve shqiptare, me të ardhura mujore deri në 50 mijë lekë, kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike. Në këtë përfundim ka arritur një raport mbi varfërinë energjetike, i cili jep të dhëna mbi tipologjinë e ndërtesave të vlerësuara, si përdoret energjia në ndërtesat e vlerësuara, raportit kosto e energjisë/ të ardhura për përballimin e shërbimeve të domosdoshme minimale jetësore etj. "Familje të cilat kanë të ardhura 40 mijë lekë do të kenë vështirësinë më të madhe të pagesën e faturës së energjisë elektrike. Kjo përqindje fillon që të ulët, por diferenca ndoshta nuk është kaq e theksuar. Kjo ndjehet të cilat kanë të ardhura mesatare mujore mbi 50 mijë lekë, të cilët janë shprehur se rreth 34 për qind e tyre kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike. Familje, të cilat kanë të ardhura mesatare 90 mijë lekë, pothuajse 94% e tyre kryejnë sjellje si mbyllja e dritave, apo ngrohja vetëm me një dhomë, ngrohja më pak e ushqimeve, pra kryejnë veprime që synojnë të ulin kostot e faturës së energjisë elektrike."-thuhet në raport.

Ministri i Financave Ahmetaj Ahmetaj: Drejt industrializimit të ekonomisë

Nisi në Shqipëri aktivi netin kompania italiane në sektorin automotiv. Më konkretisht kjo kompani merret me prodhimin e pjesëve specifike të guarnicioneve të makinave, shiritat me fije metalike dhe sintetike që vendosen si skelete në pjesën e brendshme të profileve të gominave të makinës dhe kabinës elektrike. Kjo kompani u vizitua nga ministri i Financave Arben Ahmetaj, i cili tha se për vendin tonë kjo do të jetë një industri me vlerë të shtuar në ekonomi. "Këtu jemi në një fabrikë të re, të ndërtuar nga grupi Martinetto, të cilët prodhojnë produkte specifike për industrinë automotivë. Kanë vetëm dy muaj që kanë filluar. Siç e shikon, industria është pothuajse e gjitha robotike, pra nuk është nga ato industri ku punësohen me qindra e me mijëra, por është nga ato industri që kanë vlerë të shtuar serioze për ekonominë shqiptare. Është realisht një nga dy prodhuesit e këtyre produkteve specifike në botë.




Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, gjatë takimit të djeshëm në kompaninë italiane

INDUSTRIALIZIMI

Industria është pothuajse e gjitha robotike, pra nuk është nga ato industri ku punësohen me qindra e me mijëra, por është nga ato industri që kanë vlerë të shtuar serioze për ekonominë shqiptare. Është realisht një nga dy prodhuesit e këtyre produkteve specifike në botë.

në Japoni, për eksport në Australi, për eksport në Amerikë, madje përfitojnë edhe nga marrëveshja e tregtisë së lirë që ne kemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo dhe diku tjetër në Europë. Unë besoj që, ajo që qeveria "Rama 1" kishte në axhendën e vet, në mandatin e parë, dhe tani po e shtyn me forcë, industrializimi i lehtë i vendit, stili italian sigurisht, pra kompani

të vogla dhe të mesme që prodhojnë produkte specifike për eksport, është duke ndodhur. Sigurisht është rrugë e gjatë, por është duke ndodhur", tha ministri Ahmetaj. Kompania, e cila erdhi për herë të parë në Shqipëri në gusht 2017, filloi aktivitetin brenda një kohe shumë të shkurtër, në muajin dhjetor. Produkti eksportohet në të gjithë vendet e botës, në Europë, Azi e Amerikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për Rrëzimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit":

I - Rishpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e "Përkthyesit"

Kandidatit duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për tu pajisur me Çertifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 Mars deri më 16 Mars 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 16 Mars 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike** nga data **12 Mars deri më 16 Mars 2018** në adresën: **info@kpa.al**. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noteruar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimitin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Një 43-vjeçar është ka rënë në prangat e policisë, pasi ishte shpallur në kërkim si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal për kultivimin e drogës. Policia e Lezhës në bashkëpunim me policinë e Matit arrestuan në orë të para të mëngjesit të djeshëm, në kullën e prindërve të tij, shtetasin Alban Gjergji. 43-vjeçari ishte shpallur në kërkim prej dy vitesh nga gjykata e Krimeve të Rënda, e cila ka caktuar ndaj tij masës e sigurisë "arrest



Momenti i arrestimit të Alban Gjergjit

Alban Gjergji, i shpallur në kërkim prej 2 vitesh

Në kërkim për kultivim droge, arrestohet në kullën e prindërve 43-vjeçari nga Laçi

me burg". Gjergji akuzohet për veprat penale "Grup i strukturuar kriminal dhe kryerjen e veprave penale nga organizata kriminale" dhe "Kultivim i bimëve narkotike, kryer në bashkëpunim". Ai u shpall në kërkim në muajin nëntor të

2016, por specialistët për Hetimin e Narkotikëve në drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në bashkëpunim me Policinë e Matit, mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative, bënë të mundur ditën e djeshme arrestimin e 43-

vjeçarit duke finalizuar me sukses operacionin e koduar "Kulla". Policia ka goditur mbi 15 raste të kultivimit të kryera nga ky grup kriminal, si dhe ka arrestuar më parë disa persona si pjesë e këtij grupi të strukturuar.

Dosja "Habliaj", ish-ministri i Brendshëm nën hetim për trafikimin e narkotikëve të kryer në bashkëpunim

Hetimet për Tahirin, prokuroria letër-porosi në Itali

Kërkohen dëshmitë e Moisi Habilajt dhe të ekstraduarit Nezar Seiti

TIRANË

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dërguar një letër-porosi drejt autoriteteve italiane, për të kërkuar ndihmë për hetimin e nisur ndaj ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Grupi i hetimit kërkon nga prokuroria e Catanias, t'i vihen në dispozicion dëshmitë e të gjithë të arrestuarve në Itali, si pjesë e një grupi narko-trafikimi për çështjen "Habliaj". Mes të arrestuarve, prokurorët kërkojnë të pyetet edhe i dyshuari si kreu i grupit kriminal, Moisi Habilaj. Kjo pasi sipas organit të akuzës Saimir Tahiri i njeh Habilajt dhe si argument sjell daljet jashtë shtetit të tij me automejtin "Audi" që ndërkohe i ishte shitur Moisi Habilajt. Prokuroria ka përdorur argumentin se Tahiri për shkak të lidhjeve farefisnore dyshohet të ketë favorizuar Habilajt për kultivim kanabisi. Ndërkohë organi i akuzës kërkon edhe pyetjen e Nezar Seiti, i cili ushtronte si financieri i grupit kriminal, i cili ndodhet në burg në Shqipëri, por u ekstradua drejt shtetit fqinj, në kundërshtim me ligjin. Në letër-porosi shpjegohet se, ndonëse u arrestua në Shqipëri dhe qëndroi për disa muaj deri në ekstradimin e tij në 25 janar 2018, Seiti pati refuzuar të japë shpjegime rreth çësht-



Saimir Tahiri

LETËR-POROSIA

Mes të arrestuarve në këtë çështje, prokurorët kërkojnë pyetjen e të dyshuarit si kreu i grupit kriminal, Moisi Habilaj. Kjo pasi sipas organit të akuzës, Saimir Tahiri i njeh Habilajt dhe si argument sjell daljet jashtë shtetit të tij me automejtin "Audi", që ndërkohe i ishte shitur Moisi Habilajt.

tjes. Për këtë arsye, grupi i hetimit, pret që të administrojë përgjigjet që ai do të japë gjatë ekzekutimit të letërporosisë nga hetuesit italianë. Ekstradimi i Seiti shkaktoi përplasje të forta institucionale, madje pati dhe akuzë nga opozita se ai u largua për t'i kycur gojën, pasi kishte vendosur të fliste kundër ish-ministrit të Brendshëm. Gjithashtu, më

herët, Prokuroria e Durrësit nisi hetimet në lidhje me dyshimet e ngritura mbi ekstradimin e Nezar Seiti. Organi i akuzës në Durrës, nisi hetimet konkretisht ndaj Prokurorisë së Krimeve të Rënda, prokurorisë së Tiranës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burjeve, të cilat kanë trajtuar rastin në fjalë. Sakaq rreth 2 javë më parë prokurorët e çështjes kërkuan ndihmë edhe nga Greqia, për të marrë informacion rreth lëvizjeve të ish-ministrit Tahiri në territorin fqinj. Më herët Saimir Tahiri është marrë në pyetje në ambientet e prokurorisë në lidhje me këtë çështje. Pasi dha dëshminë e tij përpara

organit të akuzës ish-ministri reagoi për mediat ku theksoj se është i hapur për hetimin. "Me kërkesën time u paraqita për të dhënë shpjegimet e mia dhe për të shprehur gatishmërinë sot dhe kurdoherë për t'i shkuar të vërtetës deri në fund me çdo mjet timin, dhe disponibilitetin personal për t'iu përgjigjur çdo kërkesë të prokurorisë. Do ju kërkoja që atë që bëra me prokurorët brenda mos ta bëja edhe këtu, se do ishte punë e dyfishtë. Unë jam tërësisht i disponueshëm për t'iu përgjigjur çdo pyetje, i hapur për çdo hetim, do t'i shkoj deri në fund të drejtës dhe të vërtetës sime", është shprehur Tahiri. Hetimet ndaj Saimir Tahirit nisën në tetor të 2017, pas arrestimit të Moisi Habilajt dhe disa bashkëpunëtorëve të tij në Catanias. Ish-ministri Tahiri është nën hetim për trafikimin e narkotikëve të kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, si edhe "korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë".

Grabitja në Shirq, lihen në burg 3 autorët, mes tyre edhe nipi i zonjës së shtëpisë

SHKODËR - Dy autorët e grabitjes në fshatin Shirq në Shkodër, Kristian Marashi dhe Julian Vatikaj janë lënë me masën e sigurisë "arrest me burg" nga Gjykata e Shkallës së Parë e këtij rrethi. Ndërsa, personi i tretë i arrestuar nga policia vendore, Altin Lukaj u la me masën e sigurisë "arrest me burg" me afat 12 ditë. Ky i fundit është denoncuar nga i zoti i shtëpisë, Mark Alia si bashkautor në ngjarjen e ndodhur pak ditë më parë. Bëhet fjalë për Altin Lukajn, nipin e zonjës së shtëpisë ku u bë grabitja. Pronari i banesës Mark Alia e ka denoncuar nipin e gruas së tij duke thënë se e ka njohur dhe se edhe ai është bashkautor në këtë ngjarje. Ngjarja për të cilën akuzohen të arrestuarit ndodhi mesnatën e 20 shkurtit. Kristian Marashi dhe Julian Vatikaj, të cilët u kapën pak orë pas grabitjes kanë pranuar që të dy se ata janë autorët e ngjarjes në fshatin Shirq. E vetmja gjë që kanë kërkuar avokatët mbrojtës në këtë rast është një masë më lehtësuese duke qenë se dy autorët Kristian Marashi dhe Julian Vatikaj kanë pranuar se janë ata personat që kanë shkuar për të grabitur banesën e 72-vjeçarit Alia. Ndërkaq, Altin Lukaj ka deklaruar se nuk ka asnjë lidhje me grabitjen e ndodhur. Ky shtetas është denoncuar nga i zoti i shtëpisë, i cili pretendon se e ka njohur në zë, por edhe konstruktin e trupit. Por, i pandehuri Lukaj është shprehur dje para gjykatës se ai ka qenë duke parë një ndeshje futbolli dhe madje kjo është e filmuar dhe se gjykata mund ta marrë si provë. Në fund të seancës gjyqësore, togat e zezat të Shkodrës vendosën lënien në qeli të Vatikajit dhe të Marashit. Ndërsa, për Altin Lukajn u vendos masa e sigurisë "arrest me burg" me afat 12 ditë.



se.ni

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Tretë për shitjen e pasurisë së paluajtshme Apartament, me sipërfaqe 98.39 m2 (nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nënë metra katrorë), e regjistruar në Zonën Kadastrale Nr. 8603, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 322, datë 19.11.2004, Numri i Pasurisë 26/121+2-7, Vol. 17, Faqe. 243, me adresë: Lagjia "28 Nëntori", Vlorë, në pronësi të Edlira Allaj, për kredinë e marrë pranë Bankës NBG Albania Sh.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i tretë është 15,360.00 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 22.03.2018, ora 16:00, në adresën: Qendra e Zhvillimit të Ankandëve Publike Përmbarimore ("QZHAPP"), me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofrues duhet të deponojë si garanci në logarinë e ARB me IBAN AL21901110510027173510018018 në EURO pranë Bankës NBG Albania shumën prej 10 % (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 3, Tiranë, tel: 042 252888, ose në adresën e email-it: info@arb.al

Shoqëria Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.7/156 e llojit "Tull" + Ndërtesë", e ndodhur në ZK.2693, Milot, Laç, Kurbin., në pronësi të H.Shabani, Vënë në hipotek për shumën 7,660,000 Lekë. Çmimi fillestar në ankand është 5,600,000 Lekë.

Ankandi zhvillohet në datë 02.03.2018, ditën e Premte ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë Info.Tel:044503458 ose E-mail: shoqenapermbarimoreata2010@gmail.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbuesë Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë "Tull", me sipërfaqe 540 m2, e regjistruar në ZVRFP Vlorë. ZK8604 me nr.pasurie440, vol. 18, fq.94 dhe ndërtesa mbi të me sipërfaqe 300 m2 e përbërë nga pasuria me nr.40-ND1, vol.16, fq.105 me sip.150 m2 dhe pasuria me nr.440-ND, vol.26, fq.106, me sipërfaqe 150 m2 e ndodhur në Lagjen "1 Maj", Vlorë. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 8.345.635 (ete milion e treqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e treqind e pesë) LEK ose 60,480 (gjashtëdhjetë mijë e katërdhjetë) EURO. Ankandi dytë zhvillohet me datë 19.03.2018, ora 16:00 në ambientet e Zyritës së përmbaruesve gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shylla", vllr nr.8/1, kt.4, Tiranë.

SHKODER - Afro një javë pas aksidentit tragjik të ndodhur në aksin Shkodër-Velipojë ku humbën jetën 4 pjesëtarë të familjes Preka (babai e 3 fëmijët) si dhe u plagosën 3 të tjerë, ekspertë nga Tirana kanë marrë në dorë hetimet për zbardhjen e shkakut të këtij aksidenti. Nga raporti paraprak mësohet se 40-vjeçari Edmond Preka, i cili drejtonte automjetin "Alfa Romeo" ka qenë me shpejtësi tej normave të lejuara. Ndërsa, mësohet se aksidenti kanë ndikuar edhe mungesa e ndricimit në rrugë dhe lagështia. Po ashtu ka dyshime se dy drejtuesit e makinave mund të kenë qenë duke udhëtuar me drita të gjata, çka mund ta kenë vështirësuar shikimin e njëri-tjetrit. Por, pa faj nuk është

Kunata, të mbijetuarës: 0 nusja e vllaut tem, Zoti të dhasht forcë

Aksidenti me 4 të vdekur e 3 të plagosur në Velipojë, ekspertë nga Tirana për të nxjerrë fajtorin



Viktima Edmond Preka me dy vajzat

të dhe drejtuesi i fuoristradës. Sipas ekspertëve edhe ky automjet, me të cilin udhëtonin Sokol Muja dhe Andrea Gjergji ka qenë duke ecur me shpejtësi të lartë. Ndërsa, bëhet me dije se para aksidentit, këta dy të fundit

kanë qenë në një lokal dhe kanë konsumuar alkool. Përplasja mes dy mjeteve ka ndodhur në vijën ndarëse të korrisve, çka e vështirëson edhe nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare. Përplasja e dy automjeteve ishte fatale për babain 40-vjeçar, djalin 6 muajsh si dhe dy vajzat 5 e 10 vjeç. Aksidentit i mbijetoi Evisa Preka, e cila ndodhet në spitalin e Shkodrës jashtë rrezikut për jetën. 36-vjeçarja ende nuk e ka mësuar me lajmin e dhimbshëm, dhe



Aksidenti në Velipojë

kërkesa e saj për mjekët është që të kujdesen për familjarët e saj, pasi mendon se bashkëshorti dhe fëmijët e saj janë gjallë. Familjarët kanë zgjedhur t'ia fshëhin këtë lajm të tmerrshëm derisa gjendja e saj shëndetësore të përmirësohet. Por, kunata e Evisës ka ndarë një postim mjaft prekës në rrjetin social

"Facebook". Pas humbi vëllanë, dy mbesat dhe nipin, ajo i shkruan me një dhimbje të papërshkrueshme kunatës së saj, të cilës nuk gjejnë forcë për t'i treguar të vërtetën. "O nusja e vllaut tem zoti të dhaf forcë me përballu humbjen e familjes tande. T'i past Krishti në pariz", - ka shkruar ajo.

Viktima Elena Avdillari bëri 'check-in', u kthye në port nga kufitarët

Klodiana Haxhij
DURRËS

Përplasja e dy automjeteve në Maminas, Policia e Durrësit: Aksident i pastër

"Shoferi i 'Benz'-it s'ka lidhje me 23-vjeçarën"



Vrau pronarin e një lavazhi në Sarandë, kapet pas 3 vitesh i riu nga Mamurrasi

ITALI - Një 27-vjeçar shqiptar është arrestuar nga policia italiane, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje. Bëhet fjalë për shtetasin Keivi Hysa nga Mamurrasi, i cili akuzohet se ka vrarë me armë zjarri pronarin e një auto-lavazhi makinash në vitin 2015, në qytetin e Sarandës. Mësohet se i riu u kap dje në Sesto San Giovanni si rezultat i koordinimit dhe bashkëpunimit mes ZQK Interpol Tirana dhe ZQK Interpol Roma/Itali. Burime nga policia bënë me dije se Keivi Hysa ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. 23-2015-13, datë 17.07.2015, ka caktuar masën e sigurimit personal, "Arrest me burg" për veprën penale të "Vrasje me paramendum" e kryer në bashkëpunim. Ngjarja për të cilën akuzohet 27-vjeçari ndodhi në datë 10.07.2015 rreth 01:00, në qytetin e Sarandës. Si rezultat i një mosmarrëveshje për motive të dobëta të ndodhur një natë më parë, me pronarin e një auto-lavazhi makinash shtetasin E.M., i kërkuar Hysa në bashkëpunim me shtetasit E. H. dhe L. H., kanë vrarë me armë zjarri shtetasin E.M. ZQK Interpol Tirana, në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, po kryejnë të gjitha veprimet procedurale për ekstradimin sa më të shpejtë në Shqipëri.

Pasagjerja 23-vjeçare Elena Avdillari dhe shoferi i taksisë Bujar Agalliu humbën jetën aksidentalisht, pas goditjes nga automjeti tip "Benz" në afërsi të Maminasit". Ky është përfundimi, në të cilin ka arritur policia e Durrësit, duke rrëzuar kështu të gjitha dyshimet se aksidenti tragjik në autostradën Tiranë-Durrës mund të ishte vrasje. Mësohet se policia e qytetit bregdetar ka dërguar në prokurori dosjen e aksidentit të ndodhur në orët e vona të mbrëmjes së të mërkurës me pasojë vdekjen e të resë nga Tirana dhe 60-vjeçarit Bujar Agalliu nga Durrësi. Grupi hetimor ka marrë në shqyrtim pamjet e vëna në dispozicion nga karburanti ku ndodhi përplasja e dy mjeteve dhe pasi janë analizuar pamjet dhe provat e grumbulluara është arritur në konkluzionin se ngjarja është aksidentale, duke përjashtuar mundësinë e një vrasjeje të mundshme. Sipas hetuesve të çështjes, karburanti ka pasur funksionale 2 nga 4 kamerat e sigurisë, të cilat kanë filmuar vetëm përplasjen e benzit-taksi me targa DR 475 TX me tabelën e cmimeve në pjesën e jashtme të karburantit. Rezulton se shkak i aksidentit është goditja nga pas e benzit-taksi që drejtohej nga Bujar Agalliu nga automjeti tip "Benz" tip "M1" që drejtohej nga 34-vjeçari Fatjon Zhaborja nga fshati Rragam i Tropojës, i cili është shpallur në kërkim. Ekspertët kanë konkluduar se Zhaborja ka qenë me shpejtësi skëterre, mbi 200 km në orë dhe ka goditur nga pas në parakalim e sipër taksinë ku udhëtonte 60-vjeçari Agalliu dhe pasagjerja Avdillari. Parakalimi i gabuar nga Fatjon Zhaborja si dhe rruga e dëmtuar janë përcaktuar si



Taksisti Bujar Agalliu



23-vjeçarja Elena Avdillari

23-VJEÇARJA
"Gazeta Shqiptare" ka siguruar biletën e tragjetit që 23-vjeçarja, Elena Avdillari kishte prerë për të udhëtuar drejt vendit fqinj. Rezulton se e reja ka bërë check-in në orën 19:57 të së mërkurës. Tragjeti ka pasur nisjen në orën 22:00. Pas check-in-it, Avdillari është kthyer nga Policia Kufitare pasi kishte shumë hyrje-dalje nga Shqipëria drejt Italisë. Vetëm, për vitin 2017, mësohet se ajo ka bërë 14 hyrje në portin e Durrësit.

shkak i aksidentit. Ndërkaq, grupi hetimor ka dalë në konkluzionin se viktima 23-vjeçare nuk ka asnjë lidhje me autorin e aksidentit dhe ish-pronarin e mjetit Dardan Gjeka. Të resë nga Kombinatit iu gjet një biletë në çantë për të udhëtuar me linjën Durrës-Bari. Zyrtarisht, grupi hetimor ka bërë me dije se vajza është paraqitur në port, por nuk është paraqitur para sportelit të Policisë Kufitare për të vulosur pasaportën. Ndërkaq, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar biletën e tragjetit që 23-vjeçarja, Elena Avdillari kishte prerë për të udhëtuar drejt vendit fqinj. Rezulton se e reja ka bërë check-in në orën 19:57 të së mërkurës. Tragjeti ka pasur nisjen në orën 22:00. Pas check-in-it, Avdillari është kthyer nga Policia Kufitare pasi kishte shumë hyrje-dalje nga Shqipëria drejt Italisë. Vetëm, për vitin 2017, mësohet se ajo ka bërë



Faksimile e biletës së tragjetit

PARAKALIMI I GABUAR

Ekspertët kanë konkluduar se Zhaborja ka qenë me shpejtësi skëterre, mbi 200 km në orë dhe ka goditur nga pas në parakalim e sipër taksinë ku udhëtonte 60-vjeçari Agalliu dhe pasagjerja Avdillari. Parakalimi i gabuar nga Fatjon Zhaborja si dhe rruga e dëmtuar janë përcaktuar si shkak i aksidentit.

14 hyrje në portin e Durrësit. Po ashtu mësohet se policia italiane kishte informacione se Elena Avdillari punonte në një lokal në Durrës, por nuk është përcaktuar nëse ajo ka bërë

tetin fqinj dhe për këtë autoritetet e këtij vendi u kishin kërkuar autoriteteve shqiptare për mos lejimin e saj drejt Italisë.

Korrupsioni me tenderin në vlerën 54 mln euro, më herët u pyetën Haxhinasto e Dervishaj

Abuzimi me rrugën Tiranë-Elbasan, dëshmia në Prokurori e kreut të ARRSH

Afrim Qendro: U pyeta për dijeninë time mbi çështjen

Kreu aktual i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Afrim Qendro është paraqitur ditën e djeshme në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për t'u pyetur lidhur me ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan. Ai dha shpjegime për llogari të hetimit të nisur ndaj tre ish-zyrtarëve të ARRSH-së të akuzuar për "korrupsion" gjatë ndërtimit të rrugës. Ai qëndroi për afro një orë përballë hetuesve dhe burime pranë organit të akuzës, thanë se Qendro, është pyetur për kohën kur ka mbajtur detyrën e nëndrejtorit të ARRSH. Qendro u fut në prokurori rreth orës 11:00, pasi dha dëshminë përpara prokurorëve, ai u shpreh për mediat se deklaroi atë që kishte dijeni për çështjen. "Dhashë shpjegime për rrugën Tiranë-Elbasan në cilësinë e detyrës që kam. Jam gati që të dëshmoj përsëri, nëse do të thirrrem nga prokuroria"-u shpreh Afrim Qendro. Afrim Qendro ka qenë ish-zy / drejtor i ARRSH në kohën që drejtues ishte Dashamir Xhika i arrestuar për dy dosje, të Gjinarit dhe Tiranë-Elbasan. Me herët Prokuroria për Krimet e Rënda ka marrë në pyetje edhe dy ish-titullarë të Ministrisë së Transporteve, Edmond Haxhinasto dhe Sokol Dervishaj. Dy ish-ministrat e LSI-së dëshmuar në prokurori në cilësinë e personave që kanë dijeni për kontratat dhe pro-

AFRIM QENDRO

Kreu aktual i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Afrim Qendro dha ditën e djeshme shpjegime për llogari të hetimit të nisur ndaj tre ish-zyrtarëve të ARRSH-së të akuzuar për "korrupsion" gjatë ndërtimit të rrugës. Ai u pyet për kohën kur ka mbajtur detyrën e nëndrejtorit të ARRSH.



Afrim Qendro, kreu aktual i Autoritetit Rrugor Shqiptar

cesin e hetimit. Ish-ministri Haxhinasto më herët deklaroi se nuk ka frikë nga verifikimet dhe hetimet e prokurorisë ndaj tij, lidhur me abuzimet me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan, dhe aludoi se bëhet fjalë për sulme politike. "Nuk më shqetë-

sojnë as verifikimet dhe as hetimet. Unë kam bërë një drejtim politik dhe veprimtaria është e bazuar në dokumente. Koha e gjyqeve ka mbaruar dhe nëse më godasin politikisht, unë do i përgjigjem politikisht shumë rreptë"- tha Haxhinasto. Më-

sohet se verifikimet për Haxhinaston kanë nisur për shkak se nuk ka marrë masa pas disa auditeve që janë bërë për këtë rrugë. Ai u emërua ministër i Transporteve në shtator 2013, ndërsa dha dorëheqjen në shtator 2016 dhe në vend të tij u emërua Sokol Dervishaj.

HETIMET

Për dosjen e abuzimeve me rrugën Tiranë-Elbasan Krimet e Rënda kanë nxjerrë 3 masa arresti për ish-drejtorin e rrugëve Dashamir Xhika dhe Albens Allite e Aksel Qurduka, të cilët kanë qenë ish-drejtorë të Njësisë së Menaxhimit të projektit Tiranë -Elbasan. Personat e sipërpërmendur dyshohen për korrupsion dhe shpërdorim detyre me fondet dhe projektet për rrugën Tiranë-Elbasan, me një dëm që prokuroria e përllogarit në 54 milionë euro. Komunikimi i urdhrat të lëshuar për Dashamir Xhikën nga prokuroria e Krimeve të Rënda, Elisabeta Imeraj është bërë dy ditë më parë në ambientet e policisë së Elbasanit, ku Xhika qëndron i arrestuar për një çështje tjetër.



Grabitja e pronave në bregdet, gjykata jep masat për 10 të akuzuarit

Dhjetë të akuzuarit për grabitjen e pronave në Spille janë njohur sot me masat e caktuara nga gjykata e Kavajës. Gjykata vendosi masat arrest me burg për biznesmenin Ildir Karkini, në mungesë, për Asim Arkaxhiu, për Aldo Kilën, arrest me burg, për Shpendi Demën, arrest me burg, për Arben Dajan arrest me burg, për Artur Toskun, arrest me burg. Ndërsa masën për detyrim paraqitje ka dhënë për Beqir Nuredinin kyetarin e Bashkisë Rrogozhinë, Arben Kaja, Julian Zhelegu. E ndërsa pezullim nga detyra për Arbër Aliun.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programme: Climate Change Adaptation in Transboundary Flood Risk Management, Western Balkans (CCAAB II)

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The regional CCAAB II project assists Albania, Kosovo, Macedonia and Montenegro in the adaptation to impacts of climate change, particularly in the field of flood risk management. The project aims to contribute to the following improvements:

- Flood forecasts for the Drin River Basin are developed periodically
- A regional expert working group has agreed on a set of transboundary flood risk management measures
- The number of the people in the flood-affected areas who have the necessary knowledge of how to behave in an event of floods has increased.

For the support of the programme team, GIZ Office Albania is looking for a:

Driver/ logistic position

A. Responsibilities

The driver

- provides passenger transport in an official car for programme staff, official visitors and guests
- runs errands for the office, e.g. sending letters and messages, paying bills and buying office supplies
- helps with transporting goods
- completes the vehicle log correctly and conscientiously in accordance with GIZ standards
- assists with other office work.

B. Tasks

The driver

- cleans the interior and exterior of the vehicle(s) regularly
- checks oil, water, brakes and brake liquid, tyre pressure, battery levels and the entire vehicle regularly, headlights, brakes, bodywork for dents etc.
- is responsible for the project vehicle documents and their good condition, keeping a vehicle log and recording monthly maintenance
- calculates monthly petrol, oil and lubricant consumption for the daily cash fund and for forwarding monthly vouchers to cost accounting
- reports need for service and carries out minor repairs

- immediately reports all involvement of the project or office vehicle in accidents, including minor accidents, damage, loss or theft of vehicle fittings
- takes into account all available information on road conditions, accessible routes and locations.

Knowledge management

The driver

- uses all available information (including current radio news on traffic conditions) to update daily knowledge of road conditions, current passable routes and locations, and shares this information with other office drivers.

Other duties/additional tasks

The driver

- assists other colleagues as needed in other programmes if there is no travel pending,
- carries out other office work on request,
- supports the project team in the organisation of workshops and conferences.

C. Required qualifications, competences and experience

- secondary school education
- holds a valid driver's licence
- at least 5-7 years' work experience as a professional driver, with references
- no accidents in the past 3 years
- good knowledge of English, ideally knowledge of German
- discipline and punctuality
- resilience and patience
- appropriate appearance and attire (friendly manner with all passengers)
- ensures unrestricted availability of vehicles at all times and reports restrictions immediately
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana, regularly missions to local partners in Shkoder and in the region (Kosovo, Montenegro and Macedonia).
- Assignment period: until August 2018.

Please forward your application until **4th March 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

PENSIONET NGA ITALIA EMIGRANTËT SHQIPTARË

Dokumentacioni që duhet të dorëzoni pranë patronatit INAS Albania. Mënyrat e përlogaritjes së masës

Kushtet që duhen plotësuar për të përfituar pension nga Italia

Lehtësirat që ofrohen për të riatdhesuarit



Voltiza Duro

Të gjithë shqiptarët që kanë jetuar e punuar në Itali mund të përfitojnë pension nga shteti fqinj, në momentin që plotësojnë kriteret e nevojshme. Sipas ligjit italian, në momentin kur personi merr vendimin për t'u riatdhesuar përfundimisht në Shqipëri, atëherë mund të marrë pension, bazuar në dy mënyrat e përlogaritjes sipas sistemit kontributiv dhe atij retributiv. Moshë 66 vjeç e 7 muaj është kushti i parë për të përfituar pension, ndërsa kriteri i dytë është minimum 5 vite kontribute. Ndërkaq, punonjësit e siguruar deri në datën 31.12.1995, kanë të drejtën e daljes në pension në qoftë se mund të plotësojnë të paktën 20 vjet kontribute dhe punonjësit e siguruar pas datës 31.12.1995, kanë të drejtën e daljes në pension në qoftë se ata mund të kenë jo më pak se 5 vjet kontribute dhe e përfitojnë pensionin në moshën 70 vjeç. Por në rast se kandidati është regjistruar pranë INPS dhe ka paguar kontribute mbas datës 01.01.1996, në rast se merr statusin e të riatdhesuarit, përfiton pension me moshat zyrtare të daljes në pension në Itali, pa qenë domosdoshmëria e plotësimit të moshës 70 vjeç, me jo më pak se 5 vite kontribute. Aktualisht, moshë e daljes në pension për burrat është 66 vite e 7 muaj. Aktualisht janë rreth mbi 500 mijë emigrantë në Itali. Nënshkrimi i një marrëveshjeje bilaterale me shtetin fqinj do të sillte edhe më shumë përfitime për emigrantët shqiptarë, sepse do të mundësonte llogaritjen e viteve të kontributeve në të dy vendet. Ndërkaq po punohet për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje në mënyrë që edhe ata emigrantë që kanë punuar në të dyja vendet, e jetojnë në Itali, të mund të përfitojnë pension, pa qenë e nevojshme të riatdhesohen. Së shpejti pritet që Shqipëria të finalizojë marrëveshjet me Italinë dhe Greqinë pasi në këto dy vende jeton dhe punon numri më i madh i emigrantëve shqiptarë.

PËRLOGARITJA

Sistemi i ri i pensioneve italiane parashikon dy mënyra llogaritjesh për pen-



Foto ilustruese

INVALIDËT

Pensionin e invaliditetit e përfitojnë punonjësit që rezultojnë me paaftësi të përhershme për të kryer ndonjë punë për shkak të një sëmundjeje apo defekti fizike ose mendor, me humbjen e mbi 74 për qind të aftësisë për punë, të cilët duhet të kenë jo më pak se pesë vite kontribute, nga të cilat tri vite kontribute në pesë vitet që i paraprinë datës se paraqitjes së aplikimit.

sionin: sistemi kontributiv sipas kontributeve që ka derdhur gjatë jetës dhe sistemi retributiv sipas rrogave që ka marrë. Për punonjëset femra të punësuar në sek-

torin privat filloi një rritje graduale e moshës që arriti deri në 63 vite e 9 muaj. Po kështu moshë e daljes në pension të burrave u bë 66 vjeç. Në rastin e pensionit që

llogaritet mbi bazën e sistemit kontributiv punonjësit ekstrakomunitarë, të punësuar pas 1 janarit 1996, mund të përfitojnë pension pleqërie në rast riatdhesimi,

me plotësimin e 66 viteve e 7 muaj, edhe nëse nuk kanë plotësuar 20 vite kontribute. Ndërsa në rastin ku pensioni që llogaritet sipas sistemit retributiv punonjësit ekstrakomunitarë, punësuar para periudhës 01.01. 1996, mund të përfitojnë, në rast riatdhesimi, me pension pleqërie, vetëm kur plotësojnë jo më pak se 20 vite kontribute.

PENSION INVALIDITETI

Pensionin e invaliditetit, e përfitojnë punonjësit që rezultojnë me paaftësi të përhershme për të kryer ndonjë punë për shkak të një sëmundjeje apo defekti fizike ose mendor, me humbjen e mbi 74 për qind të aftësisë për punë, të cilët duhet të kenë jo më pak se pesë vite kontribute nga të cilat tre vite kontribute në pesë vitet që i paraprinë datës se paraqitjes së aplikimit. Kushti themelor për të riatdhesuarit është që ata të cregjistrohen nga listat e rezidencës në komunat përkatëse italiane, për të dëshmuar kthimin e tyre përfundimtar në Shqipëri. Për ata që riatdhesohen përfundimisht ka disa lehtësira. Personat e punësuar pas 1 janarit 1996, mund të përfitojnë pension pleqërie në sistemin kontributiv, me plotësimin e moshës (66 vjeç e 7 muaj) edhe në qoftë se nuk kanë plotësuar 20 vitet e kontributeve standard

DOKUMENTACIONI

Për të marrë statusin e të riatdhesuarit, janë të domosdoshme këto dokumente:

- Vërtetim nga njësi vendore e pushtetit lokal të zonës, që të përmbajë datën e saktë të hyrjes përfundimtare në atdhe si dhe adresën e tij aktuale.
- Fotokopje të pasaportës, duke përfshirë edhe faqen ku ndodhet vula e fundit e kthimit në Shqipëri.
- Vërtetim nga organet kompetente në atdhe, që kanë ndërprerë aktivitetin e punës.
- Dokumenti i cregjistrimit nga komuna ku emigranti ka qenë banues në Itali.

Pas përgatitjes së këtyre dokumenteve, personat e interesuar duhet të marrin një takim në Patronato Inas Cisl Albania për të paraqitur këta dokumente dhe për të bërë kërkesën për pensionin italian.

MUNGESA E MARRËVESHJES

Aktualisht janë rreth mbi 500 mijë emigrantë në Itali. Nënshkrimi i një marrëveshjeje bilaterale me shtetin fqinj do të sillte edhe më shumë përfitime për emigrantët shqiptarë, sepse do të mundësonte llogaritjen e viteve të kontributeve në të dyja vendet.

ranë, lista e së cilës ndodhet në webin e ambasadës dhe duhen miratuar nga kjo e fundit. Pas përgatitjes së këtyre dokumenteve, personat e interesuar duhet të marrin një takim në Patronato Inas Cisl Albania për të paraqitur këta dokumente dhe për të bërë kërkesën për pensionin italian. Një nga problemet serioze të migrantëve shqiptarë është informacioni. Vështirësitë e procesit migrator, përfshirë edhe ato të gjuhës, ndikojnë negativisht mbi njohjen e të drejtave të migrantëve, të cilët shpeshherë nuk i gëzojnë ato thjesht për mosnjohje të legjislacionit.

Duhet të dini që institucionet dhe ndërmjetësuesit e autorizuar, siç janë patronatet, ofrojnë për qytetarët shërbimet e nevojshme telematike. Patronati INAS Cisl Albania ofron shërbime falas për të gjithë emigrantët shqiptarë që kanë punuar e punojnë në Itali.

"Punëkërkuessit mund të shkojnë drejt agjencive private të punësimit pa shpenzuar para"

Vendimi, krijohet fondi social për përmirësimin e kujdesit shoqëror

Shërbimet nuk do të ofrohen më nga bashkia

Voltiza Duro

Për përmirësimin e politikave sociale, standardeve të mekanizave të kujdesit shoqëror si dhe krijimin e shërbimeve të reja është vendosur krijimi dhe funksionimi i fondit social. Ky vendim është marrë ditën e djeshme gjatë mbledhjes së Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme si dhe Ministrisë së Financave. Tashmë të gjitha shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të parashikuara në ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror, të cilat konsiderohen si parësore nga bashkia, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, si ndërmarrje sociale apo struktura të ngjashme me to, që operojnë në këtë fushë private. Ndërkaq, njësi e vetëqeverisjes vendore do të merret me prokurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe do të lidhë kontratat me ofruesit e shërbimit, duke u dhënë përparësi ndërmarrjeve sociale në ofrimin e këtyre shërbimeve. Ofruesit privatë, të kontraktuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat jofitimprurëse, ofrojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, si pjesë e kontratës ose e marrëveshjes së bash-

VENDIMI

"Shërbimet e agjencisë për punëkërkuessit janë falas. Agjencia nuk e ngarkon punëkërkuessin me asnjë detyrim financiar, të drejtpërdrejt ose të tërthortë, me përjashtim të pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative të çdo punëkërkuessi", - theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.




Foto ilustruese

këpunimit ndërmjet palëve. "Njësia e vetëqeverisjes vendore raporton, çdo katër muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financiar me anë të fondit social, pranë Shërbimit Social Shtetëror. Njësia e vetëqeverisjes vendore, paralelisht, monitoron ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror; sipas standardeve e treguesve të performancës, përcaktuar në marrëveshjen kontraktuale me nënkontraktorët privatë dhe sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me organiza-

tat jofitimprurëse." - citohet në vendimin e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ky fond social krijohet me financimin e fondeve të kush-tëzuara, që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; fondeve nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; të ardhurave nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; si dhe nga tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

AGJENCITË PRIVATE TË PUNËSIMIT

Tashmë të gjithë personat që kërkojnë një punë mund t'i drejtohen agjencive private të punësimit, pa paguar asnjë detyrim financiar në këmbim. "Shërbimet e agjencisë për punëkërkuessit janë falas. Agjencia nuk e ngarkon punëkërkuessin me asnjë detyrim financiar, të drejtpërdrejt ose të tërthortë, me përjashtim të pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative të çdo punëkërkuessi", - theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Ky i fundit, në mbledhjen e organizuar dje vendosi që agjencitë private të punësimit duhet të jenë të licencuara e të përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj. Këto agjenci duhet të bëjnë regjistrimin si person fizik apo juridik dhe të ofrojnë informim, këshillim si dhe vlerësim të aplikimeve për punë. Më tej, ato duhet të kërkojnë vendet e punës e të bëjnë ndërmjetësimin për përcaktimin e kushteve dhe të lidhjeve e të marrëdhënieve të punës, ndërmjet punëkërkuessit dhe punëdhënësit. Ndërsa, për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit, agjencia do të zbatojë të gjitha marrëveshjet dypalëshe të qeverisë shqiptare me vendet përkatëse. Në vendim theksohet, gjithashtu, se shpenzimet për shërbimin e ndërmjetësimit, të kryer nga agjencia, do të përballohen nga pala punëdhënëse. "Agjencia siguron trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuessit. Punëkërkuessi i ndërmjetësuar në punë nga agjencia gëzon të drejtën për negociimin kolektiv, pagën minimale, kohën dhe kushtet e punës, përfitimet e sigurimeve shoqërore, mbrojtjen e pasurisë dhe të shëndetit në



Faksimile e vendimit të Këshillit të Ministrave për fondin social dhe agjencitë private të punësimit

SHERBIMET

Të gjitha shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të parashikuara në ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror, të cilat konsiderohen si parësore nga bashkia, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, si ndërmarrje sociale apo struktura të ngjashme me to, që operojnë në këtë fushë private.


punë", nënvizohet në vendim. Më tej, në këtë të fundit bëhet me dije se agjencia duhet të ofrojë punëkërkuessin për kushtet e punës dhe të punësimit, përpara fillimit të marrëdhënieve të punës. Këto agjenci private



Vaksinohen 10 mijë fëmijë dhe të rritur

Epidemia e fruthit, Ministria e Shëndetësisë merr masat

Epidemia e fruthit ka "pushtuar" vendin ku deri më tani rezultojnë 162 raste të konfirmuar e madje 2 vogëlushë poshtë moshës 1 vjeç kanë humbur jetën. Në këtë situatë alarmante, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë të gjitha masat për parandalimin, kontrollin dhe eliminimin e virusit që qarkullon në Shqipëri. Njëpër një Urdhrit nr:58 datë 16.01.2018, janë përcaktuar masat për kontrollin e infeksionit dhe parandalimin e shpërthimeve epidemike të fruthit. "U vendosën masa të kontrollit të infeksionit respirator në QSUT dhe spitalet rajonale si: Izolimi në pavione të caktuara (në pediatri dhe tek të rriturit); masa standarde të kontrollit të infeksionit dhe të transmetimit ajror; përdorim i maskave nga personeli dhe pacientët kur shkojnë në ekzaminime; sigurim i dezinfektimit të mjediseve spitalore të përdorura më parë nga të sëmurët; vaksinim i personelit; monitorim i gjendjes mbrojtëse të personelit ndaj fruthit; vaksinim brenda 72 orëve i kontakteve të personave të infektuar menjëherë në vendin ku ata gjenden." thuhet në deklaratën e Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo e fundit ka vendosur edhe raportimin e përditshëm të mungesave në çerdhe, kopshte dhe shkolla të fëmijëve dhe nxënësve të institucioneve të arsimit parashkollor apo institucioneve të tjera arsimore për parandalimin e shpërthimeve epidemike të fruthit. Aktualisht po kryhet kontrolli në çdo qendër shëndetësore për evidencimin e të gjitha rasteve të dyshuara ku rezultojnë që numri i të vaksinuarve deri më tani ka arritur në 10 mijë fëmijë e të rritur të ditëlindjeve 80'-90'.



JOB PURPOSE:
Maximize Field Force productivity and effectiveness by driving key Global and Local Initiatives. Focus on building team capabilities and selling excellence in order to establish the Novartis Pharma Field Force as best-in-class based on internal and external benchmarks.

Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Business & Administration, Medicine, Pharmacy, Biology, Chemistry or other relevant education.
- More than 5 years' experience in Pharmaceutical industry, in management of Field Force as well as in Sales Environment
- High Proficiency in English and local language (oral and written)
- Good leadership, management and planning skills.
- Excellent communications, interpersonal and negotiation skills.
- Ability to meet or exceed targets within agreed budgets and timescales – through effective leadership of the Medical Representatives team.
- Ensure effective management of the medical representatives team including training and personal development in terms of ongoing training, coaching and counseling through regular field visits and management of recruitment, performance, development and retention of representatives in the area through quality processes
- Implement with excellence the planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV-s and a Cover Letter (in English) at e-mail address: blerta.rambi@novartis.com, Deadline 07 March 2018
Only the selected candidates will be contacted.

Opinion *i* Ditës

Nga Romana Vlahutin

(Vijon nga faqja e parë)

... dëshmi e qartë e angazhimit të fortë të Bashkimit Evropian në rajon. Po aq e qartë është se populli shqiptar ka bërë një zgjedhje për ta lidhur vendin me standardet e BE-së dhe për ta sjellë atë si një anëtar të plotë në Bashkimin Evropian. Ne jemi dëshmitarë të një njihtit vullnet të fuqishëm si 27 vjet më parë, kur studentët marshuan për liri nën parullën "E duam Shqipërinë si gjithë Evropën".

Strategjia e Ballkanit Perëndimor jep një perspektivë të qartë dhe konkrete për integrimin në BE për secilin nga partnerët, progresi i të cilëve do të varet rreptësisht nga aftësia e tyre për të dhënë rezultate. Dhe ne duhet të jemi të qartë: nuk ka rrugë të shkurtra apo anashkalim të reformave thelbësore. Ende ka shumë punë për të bërë, vendime të vështira për t'u marrë.

Në këtë drejtim, zbatimi i reformave në fushën e shtetit ligjor, të drejtave themelore dhe qeverisjes së mirë mbetet qëllimi më i rëndësishëm për Shqipërinë dhe pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria ka bërë ndërkaq përpunim të konsiderueshëm në një numër reformash dhe veçanërisht në reformën në drejtësi, por shpresta dhe besimi të qëndrueshmëria e ndryshimit duhen forcuar përmes zbatimit të përditshëm dhe të prekshëm.

Qytetarët janë në qendër të këtij projekti transformimi dhe Bashkimi Evropian ka ofruar gjashtë nisma kryesore për ta mbështetur atë, që nga dyfishimi i përpjekjeve në shtetin ligjor dhe angazhimi në sigurinë dhe migracionin, deri te rritja e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, ndërlidhja, agjenda digjitale dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Lista e detyrave është e gjatë, por thelbi i saj është i thjeshtë: ambicia për ta bërë cilësinë e jetës së njerëzve në Shqipëri dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor më të mirë, ditë pas dite.

Qytetarët e Shqipërisë kërkojnë të respektohen, të mbrohen dhe t'u jepet një shans i barabartë për të përdorur talentet dhe njohuritë e tyre. Zyrtarët e zgjedhur duhet t'i shohin këto kërkesa si formën më të fortë të shqyrtimit dhe monitorimit.

Kjo duhet plotësuar me angazhimin konstruktiv në procesin demokratik midis shumicës dhe opozitës në një front të vetëm dhe të bashkuar në përparësinë që i



është dhënë integritet në BE. Siç tha Presidenti Juncker në shpalljen e Strategjisë: "Me vullnet të fortë politik, me reforma reale dhe të qëndrueshme dhe me zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjeve me fqinjët, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të ecin përpara në rrugët e tyre përkatëse evropiane. Nëse do ta arr-

ijnë dot këtë, kjo do të varet nga meritat e tyre objektive".

Ne jemi të gjithë evropianë, ne ndajmë identitetin evropian, vlerat, historinë, kulturën. Sidoqoftë, ende na duhet ta sjellim Ballkanin Perëndimor në Bashkimin Evropian, jo në një të ardhme të largët, por në epokën tonë dhe në bazë të një pune serioze, konkrete dhe të

përkushtuar. Ua kemi borxh prindërve tanë. Ua kemi borxh fëmijëve tanë. Por mbi të gjitha, ia kemi borxh vetes sonë, atyre që jemi dhe si duam të na kujtojnë - si brezi që përfundoi detyrën monumentale për ta bërë Evropën të plotë, të lirë dhe në paqe.

*Ambasadore, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

Detyra e brezit tonë

HOROSKOPI

DASHI

Keni shumë gjëra për të bërë para një ngjarje të rëndësishme që keni kohë që keni filluar përgatitjet, prandaj nxitoni nëse doni t'i përmbyllini me sukses! Që jeni të shkëlqyer tashmë e dinë të gjithë, tani duhet të tregoni nivelin tuaj të originalitetit.

DEMI

Pak shoping për të blerë diçka të këndshme do ju sjellë në humor. Keni disa programe të vogla me miqtë tuaj, përipiquni të jeni në kohë! Shmangni shpenzimet e tepërta: duhet të filloni të kurseni për një objektivi interesant.

BINJAKET

Gjithmonë të ndjeshëm dhe të hapur për eksperiencën të reja, megjithatë jeni pak të çorientuar për sa i përket objektivit. Kolegët nuk ju ndihmojnë dhe shefi vazhdon t'ju acarojë. Debate për një projekt të rëndësishëm në punë, jeni elastik, por bashkëbiseduesi juaj nuk është!

GAFORJA

Nëse ju del diçka e papritur në punë, sot do ta përfjetoni pak keq: nuk ju pëlqen të ngriheni shumë herët dhe aq më tepër të vraponi për të shmangur vonesën. Ditë ideale për një udhëtim të shkurtër ose një vizitë tek të afërmit tuaj ose të paktën këto kishit planifikuar.

LUANI

Miqësia dhe dashuria përballesh në njëra tjetrën në një ndeshje. Pa dyshim që pasioni është i fortë, megjithatë i mbajtur nën kontroll, mbijeton i heshtur. Ndjenja më intensive sot është solidariteti, miqtë ju hapin sytë mbi shumëllojtes të vështira.

VIRGJERESHA

Partner i dashuruar, por kaq i çorientuar dhe i hutuar saqë ju acaron gjithmonë. Në shtëpi të gjitha problemet rëndojnë mbi shpatullat tuaja! Gjithmonë shumë të zënë, më keq nëse keni një biznes privat me një sërë problemesh për të menaxhuar.

PESHORJA

Hëna mike në trekëndësh ushqen ëndrrat tuaja, ndërsa Marsi në kënd bashkëpunues ju vë në program për t'ju transformuar realitetin. Urani pak kundërshtues ju vë nën presion për të përfunduar diçka sa më shpejt.

AKREPI

Nëse jeni në punë do punoni pa dëshirë dhe mezi prisni të mbaroni që të shijoni darkën, që ka shumë mundësi të bëhet me të vërtetë magjike. Thoni po ftesës për një darkë romantike, ka ardhur koha të mos hezitoni më.

SHIGJETARI

Partner kapriçioz dhe pa humor, tamam si Hëna e sotme. Por nëse ndjenjat janë të forta, çdo gjë do zgjidhet pa asnjë problem. Humori i keq ashtu si vjen, ikën, retë e mëngjesit shpërndahen dhe vjet zezullojnë në darkë sidomos gjatë natës!

BRICJAPI

Kur harroni punën dhe ambiciet tuaja të paplotësuara, bëheni të adhurueshëm për partnerin dhe miqtë, të afërmit dhe të njohurit tuaj! Nëse doni të qetësoheni bëni një shëtitje të gjatë, për të shmangur debate të kota në darkë.

UJORI

Ditë intriguese për sa i përket dashurisë. Nëse jeni çift apo edhe vetëm, ju pret një mbrëmje e këndshme, e pasur me emocione të forta. Jeni gjithmonë në kërkim të miqësive të reja dhe kjo gjë ju ndihmon të pranoni të tjerët ashtu si janë!

PESHQI

Të çorientuar dhe të mërzitur nga mungesa e harmonisë nga Hëna dhe Marsi, do kaloni më shumë kohë duke fantazuar sesa duke u përballur me gjendjen reale. Pasiguria që keni nuk ju ndihmon: luftoni tendencën për t'u arratisur nga përgjegjësitë tuaja.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion i Ditës

Pse Greqia hapi "shampanjën" e festës?

Nga Habjon Hasani

(Vizion nga faja e parë)

... me Greqinë, ku më pikantja është ajo e rinegociimit të marrëveshjes së detit, e rrëzuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2010.

Nuk do të ishte bërë një zhurmë e madhe në Shqipëri, po mos të jehonte "tapa" e shishes së shampanjës që Kotzias dhe Cipras hapën në vendin fqinj, duke lënë të kuptohet se formalitetet e marrëveshjes do të mbylleshin në prill për Pashkët Ortodokse gjatë një turi festiv të Kryeministrit grek në Korçë.

Deri tani kjo histori i përngjante një "dasme greke" të ngjizur në Kretë dhe me gjasë e "celebruar" në Korçë. Fatkeqësisht, përtej folklorizimave ballkanike, e vërteta e hidhur është se për një marrëveshje kaq kardinale për interesat kombëtare qeveria shqiptare nuk kishte ndërmend të fliste as edhe një fjalë për detajet e rëndësishme të negociatave.

Shpesh, ishte trumbetuar nga kryeministri Rama se me një "shkop magjik" të gjitha problemet e trashëguara në 70 vite së bashku do të "zeroheshin". Madje makineria propagandistike mediatike e qeverisë ishte gati të rishkronte historinë e njohur të "Kalit të Trojës", ku kësaj radhe "kalin e vdekur" e paskërkesim kurdisur në shqiptarët, ndërkohë që grekërit flinin në "dafina".

Në fakt, e gjithë çështja e Delimitimit dhe përcaktimit të Shelfit Kontinental mes Shqipërisë dhe Greqisë nuk është thjeshtë një çështje "kortezi" e së Drejtës Ndërkombëtare që mund të zgjidhet me dy fundjava relaksuese të qeverive respektive. Mbi të gjitha, duhet të jetë e qartë se janë "interesat gjeostrategjike" dhe të "Zonës Ekskluzive Ekonomike" që përcaktojnë sesa i "kripur" është deti në Jonin tonë dhe sa është në pjesën greke.

Kjo maxhorancë ka meritën e saj kur ishte në opozitë që denoncoi Marrëveshjen e 2009-s si të padrejtë dhe në kurriz të interesave kombëtare të Shqipërisë. Sikurse, edhe në maj të 2015 Ministria e Punëve të Jashtme reagoi me maturi dhe përgjegjësi kur i dorëzoi ambasadorit grek në Tiranë një notë proteste në lidhje me planet e Greqisë për të eksploruar rezervat naftë dhe gaz në detin Jon, pikërisht në zonën e "Joni 5", për të cilën Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kishte lidhur marrëveshje me ndarjen prodhimi me kompaninë "Capricorn" qysh në shtator të vitit 2007.

Konkretisht, "thembra e Akilit" është zona "Joni 5" (sipas koordinatave të Shqipërisë), koordinatat e të cilit përputhen me një pjesë të "Jonit 2" (kuadrati në veri të Korfuzit sipas koordinatave të Greqisë), të cilën Athina ia ka dhënë me koncesion qysh në majin e vitit 2017 konsorciumit të kompanive "Total", "Elpe" dhe "Edisonit", të cilët si-

pas marrëveshjes me qeverinë greke shpimin e parë në det (off-shore) e kanë planifikuar gjatë 2018. Prandaj dhe ky nxitim nga pala greke për ta mbyllur sa më shpejt marrëveshjen me Shqipërinë justifikohet nga interesi i tyre, por jo nga interesi ynë.

Ajo çfarë opinioni publik duhet të dijë është fakti se interesi i Greqisë për këtë zonë rizgohet në dhjetor të 2012, kur gjigandët e nafës dhe gazit "Total", "Statoil" dhe "Exxon" kërkuan të fillojnë eksplorimin në trekëndëshin detar midis ishujve të Korfuzit, Kefalo-

se zgjidhja e preferuar e Athinës për këtë çështje me Tiranën do të krijonte një "casus belli" ndërkombëtar për të favorizuar pozitën e saj negociuese me Ankaranë, për të cilën interesi ekonomik i Greqisë është shumë herë më i madh për shkak të rezervave të jashtëza-

1 triliard USD. Mesa duket Karamanlis, Samaras dhe Cipras janë në dijeni të këtij raporti konfidencial, ndërsa për kryeministrin tonë Rama thonë se nuk është i interesuar ta lexojë.

Prandaj, në këtë lojë të paskrupullit interesash "gjeostrategjike"



Si për çudi dhe ironi të fatit ditët e fundit, kur kjo çështje mori dhenë, qeveria shqiptare po hesht frikshëm për turpin e saj. Madje po përpigjet t'i hedhë "hi syve" të publikut duke thënë se "Joni 5" (në pjesën shqiptare) nuk ka të bëjë me "Joni 2" (me pjesën greke). Këtë "mashtim të trashë" nuk e kapërdin as një nxënës i klasës së 5-të që mezi ka kaluar në gjeografi, por që nuk është qorr për të lexuar një hartë.

nisë dhe Italisë deri në gjirin e Libisë (rreth 220,000 km²)

Pikërisht, eksplorimet në këtë zonë janë de facto ushtrim i së drejtës së sovranitetit në funksion të "Zonës Ekskluzive Ekonomike", të cilën Greqia kërkoi ta zgjidhë me "valle" me fqinjën e saj Shqipërinë, ndërkohë që është me "zemër në dorë" me fqinjën tjetër, Turqinë.

Nuk kërkoi një mendje të hollë apo "konspirative" për të kuptuar

konshme të naftës dhe gazit në Egje, më së shumti në afërsi të ishullit të Qipros.

Kurse në rastin tonë në funksion të Zonës Ekskluzive Ekonomike mes Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, sipas disa hulumtimeve të specializuara dhe konfidenciale bëhet fjalë për rezervat potenciale naftë dhe gaz natyror, të cilat me përllogaritjen e çmimeve aktuale në bursat ndërkombëtare kapërcen një vlerë marramendëse tregu prej

dhe "gjeo-ekonomike" me shumë të panjohura, qeveria jonë më së paku duhet të ishte transparente, e qartë dhe përgjegjshme për atë çfarë negocion me fqinjën tonë jo vetëm në raport me institucionet kushtetuese, siç ishte rasti me institucionin e Presidentit, por mbi të gjitha, me qytetarët e këtij vendi, sepse në finale "plotfuqishmëria" e këtyre negociatave duhet të burojë vetëm nga interesi i madhor kombëtar. / Hashtag.al



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA


Nr. 598

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 24 Shkurt 2018

XHENI MHILLAJ: Ja kur do të më shihni nuse




"SË SHPEJTI DO
TE VIJ ME NJE
PROJEKT TE RI!"

E vërteta e marrëdhënies
sime me Bernardin

SUADA SHERIFI

Bukuroshja shqiptare poston
foton e ëmbël nga pushimet



ARBANA "MBULOHET"
ME TRËNDAFILA NGA
KOKA TE KËMBËT



Arbana "mbulohet" me trëndafila nga koka te këmbët, ja kush e surprizon

Nuk është hera e parë që e shohim moderatoren e TCH, Arbana Osmani të marrë trëndafila e lule. Jo më larg se e shtuna e kaluar, nisi dhe i shumëprituri, emisioni "Dua të të bëj të lumtur" ku puntata e parë ishte një sukses i vërtetë. Kësaj radhe sërisht moderatorja surprizohet me një tufë gjigande me trëndafila të kuq. Kësaj radhe ka qenë vetë stafi i "Dua të të bëj të lumtur", i cili e ka surprizuar ndërsa bënin provat gjenerale për puntatën e dytë që do të jepet ditën e sotme. Një mendim shumë i bukur shoqëruar me dedikim. "Stafi i 'Dua të të bëj të lumtur' ka kënaqësinë t'ju dhurojë këtë buqetë me lule. Buzëqeshja juaj të ishte një dhuratë e bukur për ne. Të duam, ekipi i "Dua të të bëj të lumtur".



pletri_dona Sh
Faleminderit nga zemra te gjithve per urimet. E di qe prisni foto te nje feste,por dua te ju them se nuk do e festoj.
Dje isha gati duke humbur nje person te dashur dhe faleminderit zotit cdo gje shkoj mire.
Mos ruani asgje per nje dite te vecante. Cdo dite qe jemi gjalle eshte nje dite e vecante.
Ju uroj shendet te gjithve.

Nuk feston ditëlindjen, çfarë e pengoi ish-banoren e "Big Brother 9"?

Një nga ditët më të rëndësishme të vitit pritet me padurim nga të gjithë për t'u festuar. Por mesa duket nuk është e tillë për ish-banoren e "BB9", Dona Pjetri. Ajo nuk ka preferuar të festojë ditëlindjen e saj që e kishte dje. Njëpërmjet një statusi në faqen e saj në "Instagram", ajo tregon se nuk është tip që feston një ditë të tillë, dhe jo më kot. Një nga njerëzit e saj më të dashur rrezikoi të humbiste jetën dhe kjo e ka tronditur ish-banoren. Me një mesazh sensibilizues ajo thotë të festojmë çdo ditë dhe t'u themi njerëzve se sa i duam. Rëndësi ka që gjithçka kaloi tashmë!

E ofendojnë pastaj e lavdërojnë? Reagimi i modeles nuk pritej

Ajo është një nga modelet më të njohura dhe të dashura shqiptare. Por për shkak të fansave të saj të shumtë, asaj i duhet të komunikojë edhe në gjuhën angleze e jo në shqip. Një gjë e tillë është pikasur shpesh nga ndjekësit e saj shqiptarë, të cilët e kanë ofenduar me fjalë tepër të ulëta modelen. Por ajo që nuk pritej nga njëri prej tyre, shqiptar, është se mesa duket ka ndryshuar mendje lidhur me epitetet që i ka vënë modeles. Në një postim të fundit të Eminës ajo tregon mesazhin që i ka ardhur në inbox nga fansi shqiptar, i cili para disa kohësh e kishte ofenduar. Ndërkohë që më vonë ai ka



ndryshuar mendje duke e lavdëruar në postimin e fundit. "Në fillim më shan, pastaj më lëvdon,-thotë modelja,- Nuk e di çfarë ndodh me këta njerëz!". Vërtetë që nuk di si të sillësh në situata të tilla.



Roza vijon ritualin pas një viti, ndez sërisht rrjetin duke u zhveshur

Mesa duket si vitin e kaluar edhe këtë vit, moderatorja simpatike e "Why Not", Roza Lati ka vendosur ta kthejë në ritual ndryshimin e pamjes së saj duke bërë edhe një set provokativ fotografik. Vitin e kaluar ajo është komentuar në fotot e saj edhe nga grupi i saj i preferuar, që do të donte ta kishte në dasmën e saj, Cypresshill. Ndërkohë që tashmë në fund të shkurtit, ajo vjen me një pamje tejet provokuese e veshur vetëm me një xhakëtë xhins dhe poshtë saj, në vend të bikinit, bizhuteri tepër seksi, të cilat e bëjnë akoma më "hot" pamjen e saj. Tashmë blonde-platin, Roza në fotot e saj të fundit duket një bombë e vërtetë.



Në pritje të ëmbël, Adelina Tahiri bën dedikim prekës për...

Pasi e bëri të ditur lajmin që ishte shtatzënë, vëllai i saj, këngëtarja e njohur, Adelina Tahiri vendosi ta bënte publik lajmin duke bërë një falënderim të veçantë. Në një postim në faqen e saj në Instagram ajo tha se është duke kaluar një periudhë shumë të veçantë dhe emocionuese si çdo femër që pret fëmijën e saj. Por nuk ka harruar të falënderojë nga zemra të gjithë ndjekësit e saj për fjalët e ndjera dhe urimet e tyre. Gjithashtu, ka shtuar se dashuria nuk ka racë e as ngjyrë e as moshë. "Doja t'ju falënderoj të gjithëve për përkrahjet, për mirëkuptimin dhe çdo gjë të bukur të dedikuar! Falemnderit nga zemra është fjalë e vogël! Jam në një gjendje aq të emocionuar dhe të mirë sa që nuk ekziston fjalë në fjalor të shpjegoj dhe të tregoj si ndihem, dhashtë



Zoti çdo femër të kalojë në këtë periudhë më të bukur jetësore, që asnjë gjë s'më bën më të lumtur se sa shtatzënia. Dua vetëm një gjë të shtoj, çdo gjë në jetë bëhet me dashuri, dashuria nuk ka kufij, as fe, as racë, as moshë e as kufij! Unë nuk harroj kush jam, rrethanat nuk më ndryshojnë e as njerëzit që më rrethojnë. Jam krenare që jam shqiptare! Kam lind dhe do vdes e tillë, shkruan Adelina në postimin e saj. Këngëtarja është shkëputur nga bota e muzikës, pasi lidhi kurorë me avokatin e njohur maqedonas dhe tashmë janë në pritje fëmijës së tyre të parë, që është djalë.



E ulur në prehër, bukuroshja shqiptare poston foton e ëmbël nga pushimet

Prej kohësh është shkëputur nga vëmendja e mediave rozë dhe nga ekrani. Mesa duket bukuroshja Suada Sherifi, ka vendosur të shfrytëzojë këtë periudhë "pause" duke u "arratisur" me bashkëshortin në vendet e lindjes, aktualisht në Dubai. Fotot e saj ekzotike tregojnë që është duke kaluar një periudhë fantastike krah familjes së saj. Ajo që bie më tepër në sy është mungesa e fotove me bashkëshortin, por kemi arritur që në "Instastory" të "kapim" një foto shumë të ëmbël të çiftit. Edhe kësaj radhe pa shfaqur fytyrën e tij, ajo shfaqet e buzëqeshur në prehrin e bashkëshortit të saj.


Rikthehet Oriola, prezanton "bombën" e radhës

Modelja më seksi e momentit prej kohësh është "shkëputur" nga postimet e saj provokuese në "Instagram". Mesa duket do të vijë surpriza prej saj për shkak të kësaj "heshtjeje" të gjatë. Oriola Marashi jo më larg se dje postoi në "Instastory" një foto ku kishte mbuluar fytyrat e dy personave të tjerë në ashensor ku shfaqej vetë sportive, por provokuese njëkohësisht. "Së shpejti një këngë e re", shkruan Oriola në foton e saj. Duke qenë se është shpallur prej kohësh si pjesë e grupit të njohur të OTR me në krye Noizy-n, mendohet se edhe kësaj radhe mund të jetë pjesë e tyre. Por gjithçka pritet të shihet, se ku do ta shohim modelen bukuroshe.



Stanaj i bashkohet Dua Lipës në koncertin në Prishtinë

Një tjetër surprizë pritet të ndodhë së shpejti në Kosovë. Edhe pse s'ju bashkua për 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, Dua Lipa do të performojë në Prishtinë në 10 gusht. Por nuk do të jetë vetëm, ndërkohë që një tjetër këngëtar i famshëm botëror me origjinë shqiptare do të jetë pjesë e këtij festivali. Në festivalin e muzikës "Sunny Hill" do të performojë edhe këngëtar Albert Stanaj. Këtë e ka bërë të ditur vetë këngëtarja përmes rrjetit të tij social. Këngëtarja nga Shqipëria ka thënë se mezi pret që të bashkohet me Dua Lipën për të performuar në Kosovë, që do të jetë performanca e tij e parë në Kosovë. "Hej Dua Lipa, nuk më pritët që të të bashkohem në Kosovë në festivalin e muzikës 'Sunny Hill'. I emocionuar që të performoj për herë të parë në Kosovë. Detaje të tjera së shpejti, shihemi", ka shkruar Stanaj. Ata do të performojnë në Prishtinë më 10 gusht. Me siguri që do të jetë një eksperiencë e paharrueshme, ndërkohë që Dua fitoi para disa ditësh një ndër çmimet më prestigjioze në "BRIT Awards 2018" me hitin e saj "New rules" si "Këngëtarja më e mirë femër" dhe "Artista e re më e mirë".



Edhe pas daljes nga shtëpia më e famshme në Shqipëri, edhe pse ka kaluar tashmë një vit nga "Big Brother 9", banorët e saj, kryesisht çiftet, janë gjithnjë nën objektivin e medias rozë. Kësaj radhe po flasim për bukuroshen Xheni Mhillaj, e cila në reality show-n e njohur krijoi një çift shumë simpatik me Bernardin, por që një lidhje e tillë, me përfundimin e show-t dhe daljen nga shtëpia, nuk zgjati shumë. Të gjithë shpresuan në një rikthim të çiftit dhe ishin nën kontroll të postimeve të secilit për të kapur ndonjë sinjal rikthimi. Por para disa ditësh Xheni postoi disa foto e veshur nuse në krah të aktorit të njohur të "Portokalli", Olsi Bylyku. Të gjitha këto mjaftuan për të ngritur aludime të ndryshme. Në një intervistë ekskluzive për "Blue-tooth" të "Gazeta Shqiptare", Xheni tregon të vërtetën që fshihet pas postimeve në Instagram dhe të veshurit nuse. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Prej kohësh po ju shohim që keni hedhur postime në faqen tuaj në "Instagram" me shoqërinë e BB9. Jeni kthyer përfundimisht në Shqipëri?

Po jam kthyer. Por nuk mund të them përfundimisht që do të qëndroj. Por do të rri këtu për momentin.

Me çfarë po merreni për momentin?

Akoma s'kam filluar që të merrem me diçka konkrete,



Flet ish-banorja e "BB9": E vërteta e marrëdhënies sime me Bernardin

Xheni Mhillaj: Ja kur do të më shihni nuse

"Së shpejti do të vij me një projekt të ri"





sepse jam duke u marr me gjëra tjera, si për shembull duke u sistemuar me shtëpi.

Para disa ditësh publikuat në "Instagram" një foto ku ishit veshur nuse në krah të aktorit të "Portokalli", Olsi Bylykut. Për çfarë bëhet fjalë?

Do e shihni shumë shpejt për çfarë bëhet fjalë. Mundem vetëm t'ju them që do të jetë një gjë e bukur. Por do ta lë surprizë për momentin.

Ju kanë propozuar ndonjë projekt në media? Do t'ju shohim diku së shpejti?

Për momentin përveç pjesën që kisha të "Al Pazari", asgjë të re.

Në media qarkullojnë zërat për "Big Brother Vip". A do të jeni ju pjesë e saj?

Jo, nuk do të jem pjesë e "Big Brother Vip".

Bëri shumë zhurmë postimi i bërë në "Instastory" i juaji dhe i Bernardit që koïncidonin. Të gjithë menduan se jeni kthyer bashkë. Si qëndron e vërteta?

Unë e Bernardi kemi respekt për njeri-tjetrin, por nuk jemi kthyer bashkë.

Jeni në superformë dhe shfaqeni me shumë



energji pozitive në mediata sociale. A është dikush në jetën e Xhenit, arsye e këtij ndryshimi pozitiv?

Pozitive kam qenë gjithmonë, por ndoshta pas ndarjes jam mbyll pak dhe për këtë jam dukur e mërzi-tur. Është një gjë shumë normale. Por tashmë do shoh vetëm gjëra të mira e do jem e buzëqeshur siç kam qenë më parë. Për momentin nuk është askush në jetën time e do jetë kështu për disa kohë.

Cili ka qenë propozimi më interesant që ju kanë bërë?

Për momentin nuk më

kanë bërë ndonjë propozim.

Çfarë nuk do të toleroni në një lidhje?

Tek një lidhje nuk do të toleroja tradhtinë. Është një gjë që nuk fal aspak.

Në fotot e bëra në "Instagram" kishit një nur

shumë të bukur nuseje. Kur e mendon martesën Xheni?

Për momentin këto foto do i mbaj si kujtim. Nuk e kam në plan të martohem. Kur të vijë personi i duhur edhe mund ta mendoj, por ka kohë.



Përfituesve u njihet e drejta për kompensim dhe vlerësim për tri vite

Ornela Manjani

Pronarët që kanë aplikuar për kompensim në vitet 1993, 1994 dhe 1996 kanë marrë vlerësim përfundimtar mbi pronën e konfiskuar në vitin 1945. Agjencia e Trajtit të Pronave ka publikuar listën me 1026 pronarë, të cilëve u është njohur të drejta për kompensim dhe vlerësim. Dosjet u përkasin viteve 1993, 1994 dhe 1996. Me kërkesë të Agjencisë së Trajtit të pronave është publikuar lista shtesë e përditësuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të regjistrit të vendimeve, të cilat kanë njohur të drejtën për kompensim dhe vlerësimet për vitin 1993, 1994 dhe 1996. Ndërkohë, në Agjencinë e Trajtit të Pronave presin të njihen me të drejtën për kompensim rreth 10 mijë dosje. Sipas të dhënave

Vendimet para '96-ës, ATP publikon listën me 1026 pronarët përfitues

Përditësohen të dhënat, subjektet që konsiderohen të kompensuara

zyrtare nga ATP, mësohet se që nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015, për "Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", 'Agjencia' ka përfunduar vlerësimin financiar të rreth 16 mijë vendimeve, të cilat i përkasin

